

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË KORÇË**

VENDIM

Nr. 130, Datë 22.08.2022

**PËR MIRATIMIN E PROCES VERBALIT TË MBLEDHJES TË DATES 29.07.2022
TË KËSHILLIT TË BASHKISË KORÇË**

Këshilli i Bashkisë Korçë në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi lexoi proces verbalin e zbardhur nga Sekretarja e Këshillit të mbledhjes të datës 29.07.2022, në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" neni 53, pika 8 dhe neni 54, gërma k) si dhe neni 92 e Rregullores së Funkcionimit të Këshillit të Bashkisë Korçë miratuar me VKB nr. 80, datë 30.07.2020;

VENDOSI

1. Të miratojë proces verbalin e mbledhjes të Këshillit të Bashkisë Korçë, të datës 29.07.2022 bashkangjitur.
2. Kopja e proces verbalit të miratuar administrohet nga Sekretarja e Këshillit sipas procedurave ligjore.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Erjon NEXHIPI

PROÇESVERBAL I MBLEDHJES DATË 29.07.2022

Kryesuesi i mbledhjes është kryetari i Këshillit z.Erjon Nexhipi

Ora e hapjes së mbledhjes: 13:00

Zhvillimi i mbledhjes: në sallën e Këshillit Bashkiak

Këshilltarë pjesëmarrës në momentin e hapjes së mbledhjes: 21

Sekretari i Këshillit deklaroi kuorumin prej 21këshilltarësh.

Të pranishëm nga administrata e Bashkisë: Kryetari i Bashkisë z.Sotiraq Filo dhe drejtorë të ekzekutivit

Të pranishëm në mbledhje qytetarë: 0

Pika 1 e rendit të ditës.

PËR MIRATIMIN E RENDIT TË DITËS.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi:Në lidhje me rendin e ditës pasi u shpërnda është një material shtesë për SH.A e Tregut të shumicës të fruta perimeve. Nga grupi i partisë socialiste ka diçka tjetër? Nga këshilltarët e tjerë ka diçka?

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 21

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 2 e rendit të ditës.

PËR MIRATIMIN E PROÇESVERBALEVE TË MBLEDHJES SË DATËS 30 QERHOR 2022.(me e-mail)

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Ka nga këshilltarët diçka?

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 21

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 3 e rendit të ditës

MBI DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE NGA 6% E FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN EKONOMIKE,DHE NGA FONDI I BUXHETIT VENDOR, PËR PERIUDHËN 1 – 30 QERSHOR 2022.

(Komisioni i Mirëqënies Sociale, Strehimit, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, të Drejtave të Njeriut) znj Irena Nikaj.

Këshilltare I.Nikaj: Propozoj miratimin e ndihmës ekonomike në relacionin e paraqitur nga Drejtore e Përgjithshme e Drejtorisë Juridike dhe Burimeve Njerëzore, Drejtor i Kujdesit Social Drejtore e Drejtorisë së Buxhetit dhe MFK.Për muajin Maj, janë 47 familje përfituese nga programi i bllok-ndihmës ekonomike deri në 6% të fondit të kushtëzuar. Këto familje, përzgjidhen nga ana e Administratorit Shoqëror sipas Njësive Administrative, nga familjet e pakualifikuara nga sistemi i pikëzimit me cilësimin, “Nuk ka marrë pikët e mjaftueshme” konkretisht për ato familje të cilat kanë paraqitur dosje të plotë dokumentacioni. Nga të gjitha familjet e pakualifikuara nga sistemi, për mos marrjen e pikëve të mjaftueshme, përfitojnë familjet me nivel më të ulët ekonomik, me probleme sociale dhe shëndetësore, personat mbi moshë pune, personat e vetmuar, familje me k/familjarë të ve ose divorcuar me të paktën një fëmijë, familjet rome dhe egjiptiane, sipas kriterëve të miratuara në mbledhjen e Këshillit Bashkiak me vendim nr. 5 për kriteret e buxhetit vendor dhe vendim nr.4 për kriteret e 6%, datë 27.01.2022.Për muajin Qershor 2022, është në dispozicion fondi prej 236.760 lekë si 6% të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike , nga sistemi i pikëzimit.Nga ky fond, përfitojnë 47 familje, të përzgjedhura sipas kriterëve specifike të miratuara, në shumën 120.956 lekë.Po nga ky fond përfitojnë kompensim të energjisë elektrike 25 familje, në shumën 31.552 lekë. Pagesa totale nga 6% të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike, plus energji, është 152.508 lekë.Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i buxhetit vendor ,sipas kriterëve specifike të miratuara 20 familje, me fond prej 57.574 lekë specifikuar si persona të vetmuar, persona me pamundësi fizike për të punuar, kryefamiljarë gra me fëmijë të mitur në ngarkim, kryefamiljarë mbi moshë punë, familje të komunitetit rom dhe egjiptian me probleme dokumentacioni. I propozojmë Këshillit Bashkiak miratim të kësaj pike mbështetur në gjithçka është paraqitur në relacion.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Nga këshilltarët e tjerë ka diçka për të shtuar?

Vota PRO 21

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 4 e rendit të ditës

PËR NDRYSHIMIN E KUOTËS USHQIMORE TË FËMIJËVE TË ÇERDHEVE DHE KOPSHTEVE ME USHQIM NË QYTETIN E KORÇËS.

(Komisioni i Arsimit, Sportit dhe Clodhjes), znj. Edlira Mitre(Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, dhe Mbikqyrjes Financiare)

Këshilltare E.Mitre: Nga Ndërrmarja e shërbimeve mbështetëse të arsimit dhe çerdhes ka ardhur relacioni "Për Ndryshimin e kuotës ushqimore të fëmijëve të çerdheve dhe kopshteve me ushqim

në qytetin e Korçës". Në qytetin tonë frekuentojnë çerdhet dhe kopshtet 750 fëmijë, kuota ditore ushqimore aktuale e fëmijëve është 125 lekë, ndërsa mujore kalon në 2750 lekë. Duke u bazuar tek menuja javore e përcaktuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe gramatura e përcaktuar për fëmijët dhe me çmimet e konstatuara nga INSTAT dega Korçë, 3 mujorin e fundit të 2022 kërkohet të bëhet një rritje prej 25 lekësh, pra kuota për secilin fëmijë të jetë 150 lekë, ndërsa kuota mujore 3300 lekë. Kjo rritje bëhet vetëm për shkak të rritjes së çmimeve në treg.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Komisioni i financave.

Këshilltar J.Deli: Nga ana e komisionit të financave nuk ka efekt për buxhetin, pjesa e kuotës ushqimore paguhet nga prindërit.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Të ishte kjo kaq e thjeshtë, se ne miratuar pak më përpara ndihmën ekonomike. Sa përqind është rritur ?

Ekzekutivi A.Vranishti: Ndhimja ekonomike në muajin maj është 2-fishuar, për shembull nga një familje që bëhet një pagesë 4,000 lekë është dyfishuar tani në 8,000 lekë. Ndhimja ekonomike është 2-fishuar.Edhe për kategori të veçanta.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Për të gjithë po flasim apo?

Ekzekutivi A.Vranishti: Për këto 2-3 kategori të veçanta është 3-fishuar ndihma.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Mund të them diçka?

Këshilltare A.Verushi : Janë fëmijët e atyre prindërve që janë në marrëdhënie pune apo dhe këta që janë në marrëdhënie me asistencë?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Për këtë pyetje mund ta sqarojë Monda si e kemi. Ideja është që ky material është një material që nuk po e sjellim me dëshirë, por po e sjellim për të reflektuar mbi situatën në të cilën ndodhemi dhe rritjen e çmimeve të produkteve ushqimore në të cilat ne bëjmë ato paketat ushqimore për fëmijët e kopshteve edhe të çerdheve. Kjo tarifë paguhet nga familjet dhe kthehet në trajtën e produkteve ushqimore, në ushqimet që ata marrin në kopshtet që janë me drekë apo në çerdhet. Nga ana tjetër kemi një kategori familjesh që me vendim Këshilli ne e kemi përgjysmuar këtë tarifë.Sa janë?

Përgj.Shërb.MbështetëseR.Pikuli: Janë disa familje që i kanë të dy prindërit të papunë.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Pra familje që kanë të dy prindërit e papunë ne si e kemi? Paguajmë gjysmën apo të plotë?

Përgj.Shërb.MbështetëseR.Pikuli: I mbështesim ne, jo gjysëm.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: E paguajmë 100% ne. Pra bashkia dhe këshilli e kanë miratuar patjetër për ato familje që kanë qënë në vështirësi ekonomike, ne e kemi marrë dhe e kemi miratuar një masë që ti mbështetim si familje. Ndërkohë që këtë rritjen tani që vjen për shkak të

Rritjes të çmimeve ne propozojmë që të rritet tarifa, pra të jetë një ndryshim që do ta përballojnë familjet. Pyetja ishte pse ta përballojnë familjet, ta përballojë bashkia apo jo?

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Unë doja të kuptoja se u thjeshtësua, dhe se kjo shifër që është 20% për shembull kujt i jemi referuar ?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Ajo që tha Joani është që nga ana e komisionit të financave nuk ka efekt për buxhetin, pra nuk prek buxhetin e bashkisë sepse rritet tarifa, do mblidhen më shumë lekë por do harxhohen të gjitha përsëri për të blerë të njëjtën sasi ushqimesh që bliheshe dhe më përpara por me çmim më të lartë për shkak se është rritur çmimi. Pra tarifa ka lidhje me përballimin e koston për shkak të çmimeve të rritura të të njëjtës sasi ushqimesh që ne blinim më përpara. Në këtë propozim ne besoj i jemi referuar vlerës së tregut, sondazhet, ofertat që kemi marrë.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: INSTAT-i thotë që quhet tarifë 20%. Kjo po rritet 20%.

Përgj.Shërb.Mbështetëse R.Pikuli: Që nga INSTAT-i janë marrë çmimet për të gjitha mallrat ushqimore që përbëjnë menunë javore të fëmijëve në çerdhe dhe kopshte. Edhe rezultuan që çmimet e INSTAT-it dhe nga llogaritja e kuotës për një fëmijë rezulton që kjo kuotë nuk arrin të barazohet me këto çmimet, e tejkalon.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: E kuptoj, unë bie dakord që çmimet janë rritur, po diskutoj për nivelin 20% sepse po rritet 20% nga 125 lekë dita po bëhet 150 lekë dita. Tani me këtë 20% ne konfirmojmë që INSTAT-i ka publikuar që çmimet në Shqipëri janë rritur 20%, se ky është arsyetimi që unë po përdor. Tjetër gjë se u rritën 10%, 12% kaq është indeksi i inflacionit dhe po e projektojmë këtë. Nuk e di qofsha i gabuar.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Të dhënat i keni marrë nga INSTAT-i apo nga tregu?

Përgj.Shërb.Mbështetëse R.Pikuli: Nga INSTAT-i.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Herën e fundit kur e kishin bërë këtë procedurë?

Përgj.Shërb.Mbështetëse R.Pikuli: Në dhjetor. Ne për mallrat ushqimore e kemi realizuar për periudhën 2021 dhe deri në vitin 2022.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Dakord.

Përgj.Shërb.Mbështetëse R.Pikuli: Çmimet aktuale që përdoren për fëmijët nga menunja dhe gramatura që kemi nuk na realizohet kuota 125 lekë me çmimet, prandaj kemi këtë ndryshim të kuotës.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Pyetja ime është më e thjeshtë. Këtë procedurë nga INSTAT-i kur e kemi bërë për herë të fundit. Sa vite ka që ne kemi këtë tarifë 125 lekë, se mund të jetë e vërtetë

kjo që diferenca midis menusë të themi të përcaktuar me këto çmimet e sotshme duhet të jetë 150 lekë dhe 125 ka qënë që para 10 viteve apo 5 vitesh.

Përgj.Shërb.Mbështetëse R.Pikuli: Para 3 vitesh.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Pra korrektimi nuk është bërë se çmimet janë rritur për vit, se e thënë kështu 125 me 150 duket sikur inflacioni është 20%, por korrektim çmimesh nuk kemi bërë. Kur ka qënë hera e fundit që kemi marrë një vendim këtu.

Përgj.Shërb.Mbështetëse R.Pikuli: Kemi 3 vite këtu që kuota e fëmijëve në çerdhet dhe kopshtet është 125 lekë. Para 125 lekë ishte 91 lekë. U rritën çmimet ndryshoi nga 91 shkoi 125 mbas 3 vjetësh po kërkojmë ndryshim tani të kuotës ushqimore.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Për ta qartësuar për këshilltarët po dhe për publikun meqënëse po na dëgjon. Nga këshilltarët e tjerë ka diçka?

Përgj.Shërb.Mbështetëse R.Pikuli: Në kopshtet dhe në çerdhet e qytetit kur bëhet rregjistrimi nuk ka përjashtim ose përzierje të fëmijëve me familje me dy prindër të papunë, me një prind në punë me një prind papunë ose dy punë kërkues ose të fëmijëve të familjeve që të dy prindërit janë në punë. Në kopshtet rregjistrimi në përgjithësi bëhet sipas dëshirës të prindit që ka kërkesën që të rregjistrojë fëmijën.

Këshilltare A.Verushi: Dakord kur ka më shumë, a ka një lloj selektiviteti bazuar në kapacitetin. Do të doja që në Shqipëri të përfitonin fëmijë nga prindërit që janë të pamundur.

Përgj.Shërb.Mbështetëse R.Pikuli: Nuk bëjmë diferencim.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Shiko selektivitet në rast se ka ndodhur ka qënë i tipit që u plotësuan kuotat dhe nuk pranojnë më të tjerë, dhe ata të tjerët mund të jenë fëmijë që vijnë nga prindër edhe me të dy në punë edhe me një në punë edhe me të dy papunë.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Nejse mua më vjen mirë që ka një pjesë që mbështeten.

Këshilltare E.Tare: Është numri i caktuar i këtyre fëmijëve që mbështeten kur janë prindërit e papunë? Janë në baze të kriterëve?

Përgj.Shërb.Mbështetëse R.Pikuli: Janë shumë të pakta këto raste. Bashkia ka mbështetur çdo vit një pjesë të familjeve që janë të pastreha, që janë të dy të papunë.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: E kemi të specifikuar konkretisht cilat familje ?

Përgj.Shërb.Mbështetëse R.Pikuli: Kriter të përcaktuar jo. Rregjistrojmë në kopësht ato familje të cilat e përballojnë pagesën dhe një nga dokumentat që kërkohet kur fëmija rregjistrohet në çerdhe ose kopësht është të paktën njëri nga prindërit të jetë në marrëdhënie pune me qëllim që të përballojë pagesën.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Këto familjet që mbështetim, cilat prej tyre mbështetim? Di që ka një përcaktim të familjeve që mbështetim.

Ekzekutiv A.Vranishti: Përjashtimi nga tarifat e kopshteve me vërtetimin për familjet në nevojë. Të gjitha familjet që trajtojmë me ndihmë ekonomike u japim vërtetim nga drejtoria jonë për përjashtimin nga tarifa e kopshteve.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Nga tarifa ushqimore po flasim?

Ekzekutiv A.Vranishti: Po

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Ja pra e paskemi një kriter.

Këshilltare E.Tare: Janë dhe familjet e komunitetit rom, por me kushtin kryesor ose duhet të jenë punë kërkues të papunë të regjistruar ose janë në kurset profesionale përveç kësaj kategorie prandaj pyeta Mondën ka dikë tjetër?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Këta janë, po thjesht të na i sqarojnë kriteret. Tani Monda thotë janë një numër i vogël dhe kuptohet sikur nuk janë kriteret. Në fakt janë kriteret.

Ekzekutiv A.Vranishti: Është përjashtim nga tarifat e kopshtit me drekë.

Këshilltar J.Kodra: Meqënëse shikoj që kjo ka efekt në vlerën 20% të rritjes, ka mundësi ekonomike bashkia dhe hapësira ligjore për të mbuluar një pjesë të kësaj kostoje ? Të paktën për këtë vit se mendoj se kriza do të jetë kalimtare.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: E kuptoj, është një diskutim që ne e kemi bërë përbrënda bashkisë përpara se të vinim me këtë propozim që ju është sjellë sot. Problemi është që rritja e çmimeve nuk është se afekton vetëm familjet por afekton edhe bashkinë. Kemi kosto të rritura për shumë prej shërbimeve që ne i ofrojmë po marr shembull pjesën e arsimit, kostot e ngrohjes. Kostot e ngrohjes këtë vit do të jenë shumë të mëdha dhe të paparashikueshme kjo është e keqja, se jo vetëm që janë të mëdha por ne nuk i parashikojmë dot se ne nuk e dimë si do jetë ecuria e çmimeve mund edhe të rriten shumë , mund edhe të ulen, pra vetë bashkia është në kushtet e një paqartësie financiare për ecurinë e buxhetit të saj dhe kemi gjykuar që kjo të jetë një kosto dhe ta paguajnë ata që janë drejt për së drejti përfituesit pra familjet që i çojnëfëmijët në kopsht sepse edhe ne do të duhet ti hiqim në rast se do ta mbështesnim plotësisht apo pjesërisht, do duhet të hiqim nga gjëra të tjera të buxhetit të bashkisë, ndërkohë siç thashë jemi në kushtet ku duhet të alokojmë lekë të tjera për të përballuar funksionet në nivelet që i kemi, sepse nga vjet apo këtë vit mos gaboju atë vendimin në këshill për të zgjatur dhe një muaj kohëzgjatjen e ngrohjes të qytetit, kjo është edhe për ata që ngrohen me naftë, me gaz edhe për ata që ngrohen me dru. Tani për dy të parat çmimet kanë ikur shumë lart e keni parasysh edhe vetë dhe duhet të alokojmë shume fonde. E njëjta gjë mund të na ndodhë edhe me kontratat e punëve për shkak të rritjes së çmimeve të disa lëndëve të para që përdoren në punën civile që bën bashkia. Kjo është situata, e kemi bërë diskutimin , nuk është se i kemi rënë direkt shkurt. Kemi parë sa është rritja, sa do na rriteshe ne sa ju rriteshe familjeve dhe kemi gjykuar që është një rritje e cila duhet të përballohet

tërësisht nga ato familje që janë edhe përfitues se po ta kompesonim ne do t'ja u merrnim familjeve të tjera, se ne buxhetin që mbledhim nga qytetarët shpërndajmë dhe do ta përdornim për këtë gjë që ka përfitues x familje që çojnë fëmijët në shkollë dhe kemi gjykuar që është më e drejtë nga të gjitha këto pikëpamje, duke patur parasysh edhe situatën financiare të paqartë në të cilën jemi që të vimë më këtë propozim.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Unë me sa u diskutua personalisht mendoj që të shikojmë dhe periudhën në vijim si mund të mbështeten familjet që mund të jenë në pamundësi, të vendosen kriteret më të qarta për të identifikuar këto familje se faktin që ka tre vjet që nuk është azhornuar lista e çmimeve nuk është vetëm efekti i këtij viti, por është edhe i viteve të kaluara. Për mua ne duhet të synojmë standartin në rradhë të parë dhe e dyta të mbrojmë ato kategori familjeje që e kanë të vështirë, të pamundur, duke marrë përsipër kosto si institucion pavarësisht kushteve të vështira, për ato familje që janë në mënyrë specifike, që të mos ju privojmë dhe këtë mundësi, se po ta marrësh me vlera absolute shifra nuk është e lartë sepse është në kushtet e kostove nuk është në kushtet e të bërit biznes për shërbim. Por kur ju referohemi situatës së familjeve që janë të papunëapo që janë në kushte të vështira strehimi e të tjera rrethana si këto patjetër që duhet ti ndihmojmë, dhe me ç'kuptuam ka. Nuk janë të qarta kriteret, të parashikohen dhe të sillen në të ardhmen.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Kam përshtypjen tani se më kapi pak të papërgatitur Monda, kemi kriteret për ata që i përfitojnë, thjesht unë nuk mund t'i them tani me siguri. Shiko ne e kemi bërë këtë diskutim se me të njëjtën ide kam qënë që nuk mund të mbështeten kështu me paketë të gjitha familjet, se mund të ketë familje që janë në kushte ekonomike dhe ta përballojnë ato këtë rritje dhe të mos ja lemë barrën bashkisë. Dhe ne familje e madhe jemi nuk është se jemi të imunizuar nga rritja e çmimeve dhe s'po na ndodh asgjë. Dhe ne të njëjtën situatë kemi, por patjetër që mund të shikohet, mund të ribëjmë një diskutim që mbase të shohim mundësinë e zgjerimit të rrethit të familjeve që mbështetennë një llojmënyre të diferencuara pa e shtrirë këtë mbështetje kështu në total për të gjithë pavarësisht kushteve ekonomike që kanë.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Mund të jetë për shembull jo vetëm ato që janë në kushtet ekstreme që ja u paguajmë 100%, por mund të ketë familje që kanë 2 fëmijë apo 3 fëmijë në të njëjtën kohë, që mund të jetë një trajtim i diferencuar në aspektin fëmija i parë të plotë, fëmija i dytë me 50%, që standarti të mos bjerë i ushqimit por edhe të jetë e mundur i arritshëm si shërbim nga çdo familje. Se po qe se shkojmë vetëm me arsyetimin e kostove, mund të ketë familje që do të privohen nga mundësia për ta përfituar. Ne e dimë që arsimiti parashkollor është shumë i rëndësishëm dhe për vijimësinë pastaj për socializimin.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Nejse për ta zgjeruar se është diskutim shumë i gjërë, domethënë arsimiti parashkollor ka disa alternativa, nuk është se janë vetëm kopshtet me drekë, janë edhe kopshtet pa drekë që nuk e kanë këtë kosto. Nejse aty do një analizë për të ardhmen.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Ka diçka tjetër për të shtuar nga këshilltarët?

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 22

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 5 e rendit të ditës

PËR MIRATIMIN E TAVANEVE PËRFUNDIMTARE TË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2023-2025 NË NIVEL PROGRAMI FAZA E DYTË.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Do i lutesha ekzekutivit fare shkurt. Në rast se ka ndryshim nga hera e fundit që kemi diskutuar.

Ekzekutivi D.Tabaku: Në fazën e parë janë miratuar 7 programe ku përfshiheshin 47 funksionet dhe bashkia, dhe në fazën e dytë është bërë një shpërndarje dhe janë shtuar 9 programe u shtua në këto programe Ministria e Financave ku u rekomandua të shtohesh programi i mjedisit dhe programi Arsimit i Mesëm i Përgjithshëm që në fazën e parë ishte përfshirë tek programi i Arsimit.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Nga këshilltarët ka diçka për të shtuar? Në nivelin e vlerave të lutem ka ndryshime? Jo nuk ka. Pra thjesht nga 7 program janë 9 programe duke specifikuar mjedisin dhe arsimin e mesëm të përgjithshëm.

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 23

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 6 e rendit të ditës

PËR MIRATIMIN E KRITEREVE DHE PROCEDURAVE TË PËRZGJEDHJES SË ANËTARËVE TË KËSHILLIT VENDOR TË RINISË, SI DHE TË MËNYRËS SË ORGANIZIMIT E TË FUNKSIONIMIT TË TIJ NË BASHKINË KORÇË.

(Komisioni i Rregullores, Çështjeve Ligjore dhe Administrative dhe Pasurive të Bashkisë)

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Kush është nga ata? U zgjodh si komision? Atëhere nga ekzekutivi kush e ka paraqitur propozimin?

Ekzekutivi A.Dishnica: Atëhere bëhet fjalë për këshillin vendor i cili do të funksionojë si një organ këshillimor, që funksionon pranë kryetarit të bashkisë. Ky këshill përbëhet nga 10 (dhjetë) anëtarë ku një prej tyre do të jetë kryetari i bashkisë, 4 përfaqësues nga organizatat rinore dhe 5 përfaqësues anëtarë të këshillave studentorë/qeveritë e nxënësve. Në material janë parashikuar edhe kriteret dhe fazën ku do të bëhet përzgjedhja e këtyre anëtarëve . Të gjithë kandidatët do të publikohen tek faqja zyrtare e bashkisë, prej një periudhë prej 30 ditësh ku do të kenë mundësi qytetarët të zgjedhin dhe të votojnë për kandidatët e këtij këshilli. Gjithashtu janë parashikuar edhe kompetencat që do të ketë ky këshill. Mandati i tij do të jetë për një periudhë 3-vjeçare. Parashikohet gjithashtu edhe mënyra se si do të zëvendësohet nëse dikush ikën në mes të mandatit e me rradhë. Është detyrim ligjor krijimi i këtij këshilli. Nëse ka ndonjë pyetje.

Këshilltare A. Verushi: Kam unë një pyetje. Pika ku thotë përfaqësues nga organizatat rinore tek pika b. Këtu ku thotë që përbëhet nga 10 anëtarë.

Ekzekutivi A.Dishnica: Jo jo përbëhet nga 10 anëtarë thuhet, 5 janë vajza dhe kryetari i bashkisë, 4 janë përfaqësues nga organizatat rinore dhe 5 përfaqësues anëtarë të këshillave studentorë. Pastaj ke sekretariatit i cili do të jetë pjesë përbërëse.

Këshilltare A. Verushi: Tek pika 2 ku thuhet përbëhet nga të paktën 4 deri në 6 anëtarë.

Ekzekutivi A.Dishnica: Pika 2 tek kush?

Këshilltare A. Verushi: Tek relacioni, ose është gabimisht.

Ekzekutivi A.Dishnica: Është i cituar ligji.

Këshilltar E.Petriti: Mund t'ju pyes diçka?

Këshilltare A. Verushi: Se e kanë bërë minimalisht 4 deri në 6 anëtarë.

Ekzekutivi A.Dishnica: Po.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Po nuk të thotë njeri që ta bësh tek , 41 sa këshilli.

Këshilltar E.Petriti: Meqënëse është një forum kolegjal , vendimarrje ka ky këshill?

Ekzekutivi A.Dishnica: Po

Këshilltar E.Petriti: Po që se ka vendimarrje, referuar kompetencave duhet të kushtëzohet dhe përmbajtja sepse është një ligj për organet kolegiale janë ku nuk ka një ligj të posatshtëm që kryetari , ligji për organet kolegiale është që organet kolegiale janë numër tek, sepse ne një ritualitet 5-5 si do zgjidhet. Dhe këtë e ka zgjidhur ligji ,është një ligj i posatshtëm i 94 për cënimin e organeve kolegiale duhet të merret që të jetë funksional kjo.

Ekzekutivi A.Dishnica: Edhe njëherë, vendimet e këtij komisioni do të jenë këshillimore, nuk do të jenë ekzekutive, të ekzekutueshme.

Këshilltar E.Petriti: Prandaj ta bëra pyetjen Anxhela, do të jenë vendimarrëse, sepse ekzekutivi është tjetër gjë.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Më fal, të them diçka. Domethënë e para është organ konsultativ. Pra këshillon, propozon. Dhe po të ishte organ vendimarrës pavarësisht se bëhen vendimarrëse tek, ligji e ka të sqaruar se mund të mungojë njëri dhe ngelen përsëri çift, votat ndahen, vota e kryetarit është përcaktuese. Pra e ka sqaruar ligji. Edhe sikur të ishte vendimarrës e ka sqaruar. Në rastin konkret është konsultativ, se po ti shikosh pikat këshillon njësitë e qeverisjes vendore pra bashkitë për drejtimin e politikave, vlerëson situatën e të rinjve, propozon përmirësime të politikave vendore rinore, si dhe nismat që i përshtaten nevojave të të rinjve në territorin ku veprojnë, bashkëpunon dhe shkëmben informacion me Këshillin Kombëtar të Rinisë.

Këshilltar E.Petriti: Këto nuk janë kompetenca vendimarrëse pra është konsultative.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Po ja pra ku janë pikat.

Këshilltar E.Petriti: Normalisht përderisa ligji i posatshëm e ka që vendos kryetari, se ka dhe goxha forume të tilla që ligji i posatshëm kryetari është vendimtar.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Në rastin konkret është këshillues.

Këshilltar E.Petriti: Po pse ky numër 10.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Po kështu e ka caktuar ligji.

Këshilltar E.Petriti: Jo ligji cakton një minimum maksimum.

Ekzekutivi A.Dishnica: Faktikisht me këtë numër ju referuam edhe praktikave të bashkive të tjera, ku është krijuar ky si ligj.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Ka ndonjë propozim konkret për ta ndryshuar numrin, se numri qënka i hapur me çfarë kuptova unë.

Këshilltar E.Petriti: Ndoshta mund të futësh shtresat e marxhinalizuara.

Ekzekutivi A.Dishnica: Nuk mund të fusim shtresa të tjera janë të përcaktuara kush duhet të jenë anëtarët. Duhet të jenë ose nga këshillat studentorë ose nga organizatat rinore.

Këshilltare A. Verushi: E përcaktojnë ata .

Këshilltar E.Petriti: Patjetër.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Organizatat rinore për shembull nuk është se kemi shumë, po ato që janë do bëhen pjesë. Po qe se do ishin më shumë si do procedohesh.

Këshilltare E.Menkshi: Përsa i përket grupmoshës asaj që karakterizohen si të rinj në Shqipëri, bëhet fjalë për grupmoshën nga 15 deri 29 vjet, është e përcaktuar nga institucionet përkatëse. Flas që nuk jam në këshillin studentor, kam mbaruar studimet, përfshihem në këtë kategori?

Ekzekutivi A.Dishnica: Jo pra janë të përcaktuara.

Këshilltare E.Menkshi: Mendoj se grupmosha duhet theksuar.

Ekzekutivi A.Dishnica: Po këta mund të mos jenë pjesë e këshillave studentore por janë nga organizatat rinore.

Këshilltar J.Deli: Nga organizatat rinorë, personi që do të marrë pjesë në këshillin rinor duhet të jetë patjetër nga mosha 15 deri në 29 vjeç. Siç tha dhe z. Nexhip pse është ky numër i përcaktuar? Për shembull bashkia e Elbasanit ka një numër shumë herë më të lartë se 10 veta.

Këshilltare E.Menkshi : Atëhere pse i referohemi kategorisë, kë do të quajmë të rinj në Shqipëri. Do ti referohemi të parës moshës nga 15-29 vjet.

Këshilltare A.Verushi: Organizatat vetë e kanë pjesë të tyre këtë të moshës.

Këshilltare E.Menkshi : I referohem moshës dhe asaj që ne quajmë të rinj në Shqipëri.

Këshilltar E.Petriri: E ka përcaktuar ligji nga 15-29 vjet.

Këshilltare E.Menkshi : Shumë mirë, atëhere të rinjtë nga grup mosha 15 deri 29 vjet kanë të drejtë për të kandiduar. Kriteri i parë.

Ekzekutivi A.Dishnica: Po patjetër, këto organizata dhe këshilla studentore kanë kriterin e moshës.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Atëhere edhe njëherë, e kanë përcaktuar si do bëhen pjesë. Do bëhen pjesë nëpërmjet përfaqësimit nga shoqatat. Edhe vetë këshillat studentore janë organizata.

Këshilltare I.Nikaj: Për mua përpara se të vazhdoj tek ajo që mendoj, këtu tek e drejta e riemërimit unë mendoj ta kufizojmë me vetëm një riemërim. Është e mjaftueshme që të ketë 2 mandate dhe të ketë diversifikim. Unë mendoj që organizatat rinore duhet të marrin frymësepe nga përvoja është dukur që shpesh herë ka një lloj kapje apo zënie apo manipulim, format janë nga më të ndryshme.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Mirë si funksionojnë shoqatat ne nuk e përcaktojmë dot.

Këshilltare I.Nikaj: Jo jo, unë po flas për këshillin, nuk fola për shoqatat. Këshilli rinor të mos ketë që një person të rrijë pafund atje derisa të mbushë moshën 29 apo të vazhdojë edhe 35.

Ekzekutivi A.Dishnica: Mënyra e përzgjedhjes, kriteret, përbërja dhe çdo gjë tjetër që është parashikuar në këtë material i është referuar një Vendimi të Këshillit të Ministrave që i referohet mënyrës të zgjedhjes së anëtarëve të këshillit kombëtar të rinisë. Domethënë ai vendim është bërë pjesë e vendimmarrjes së këshillit. Këto të gjitha sa u thanë janë bazuar në këtë Vendimi të Këshillit të Ministrave. Jo mund të ndërhyjmë në kriteret, por këto kriteret janë të gjitha të bazuara ligjorisht, nuk është se kemi bërë ndonjë shkelje ose kemi përcaktuar ndonjë kriter që përbën diskriminim.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Deri në 2 mandate për mua është normale.

Këshilltar E.Petriti: Dy mandate është mëse normale.

Këshilltare E.Menkshi : Jemi pjesë e këshillit të bashksië, kam të drejtë të kandidoj në këtë?

Ekzekutivi A.Dishnica: Po patjetër.

Këshilltarë A.Verushi: Këtu ku thuhet është 2 vjeçar me të drejtë rrimërimi të shtohet një paragraf , jo më shumë se 2 herë.

Këshilltar E.Petriti: Herën e parë zgjidhet pastaj emërohet?

Këshilltarë A.Verushi: Atëhere rizgjidhet.

Këshilltar E.Petriti: Njëhere thuhet zgjidhet pastaj rrimërohet. Apo nuk është formuluar mirë ajo?

Këshilltare E.Menkshi: Rizgjidhet.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Pra kjo pikë një. Ju të rinjtë mund t'ju dëgjojmë.

Këshilltari D.Hoxha: Jam dakord me mendimin e profesore Irenës pasi mendoj se zakonisht organizatat këshillet janë kapur nga disa njerëz dhe rikandidojnë e rikandidojnë. Janë gjithmonë i njëjti person. Mendoj se mandate duhet të ketë rrimërim deri në 2 herë.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Dy mandate.

Këshilltar E.Petriti: Rizgjedhje duhet të formulohet edhe një herë ajo. Pra të rizgjidhet edhe një herë.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Tjetër propozim kemi?

Këshilltare E.Menkshi : Ka ndonjë kontraditë në qoftë se të rinjtë që i kemi në këshillin e bashkisë mund të kandidojnë në këshillin vendor rinor ?

Ekzekutivi A.Dishnica: Po.

Këshilltare E.Menkshi: Thjesht pyeta për këtë. Jam dakord, nuk ka ndonjë konflikt interesi apo kontraditë.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Tjetër sugjerim ka ju lutem? Kush është dakord me ndryshimet?

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 23

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 7 e rendit të ditës

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES PËR KRIJIMIN E SHOQËRISË RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME KORÇË SH.A.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Kush e ka sjellë këtë material ekzekutivi? Më kërkesën e kujt vjen kjo?

Ekzekutivi A.Dishnica: Propozim për miratimin e marrëveshjes për krijimin e shoqërisë rajonale ujësjellës kanalizime Korçë SH.A dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave që parashikon kjo shoqëri. Në një nga pikat e kësaj marrëveshje parashikohet që kjo marrëveshje duhet ti kalojë për miratim të bazueshmërisë ligjore nga Prefekti i Qarkut. Meqënëse Prefekti i Qarkut nuk mund të bëjë miratimin e marrëveshjes, duhet që kjo marrëveshje të kalojë për vendimmarrje në Këshillin e Bashkisë. Pra marrëveshja e caktuar kërkon dhe një miratim nga këshilli.

Këshilltar E.Petriti: Vendimi i Këshillit të Ministrave që është guri i themelit i këtij ndryshim kaq të madh e përcakton qartazi që Këshilli Bashkiak miraton. Në një pikë të vendimit të Këshillit të Ministrave thotë që në kuadër të procedurave për rithemelimin e këtyre organizatave apo shoqërive tregëtare ka disa kritere, nuk mund të bëhet shoqëria e ujësjellës kanalizimeve të Korçës, që është për mendimin tim shoqëria më funksionale, më e mirë, me shembuj dhe është vlerësuar performanca. Nuk mund të vijë kaq i vakët ky material Anxhela, sepse ne tentojmë ti grumbullojmë dhe pastaj i prishim edhe atë që mund të jetë më e mira, sepse praktika ka sa të duash në Republikën e Shqipërisë. Të paktën fshati kur ka dalë nga performanca financiare, nga shërbimi nga cilësia etj etj. Domethënë kjo duhet të vijë dhe me një farë materiali paraprak që pse ne këtë dhe atë. Thjesht se e ka pasur Këshilli i Ministrave? E autorizon qëllimin Këshilli Bashkiak për të mos miratuar në parim këto lloj apo e ka Prefekti?

Ekzekutivi A.Dishnica: Ne fillimisht në shkurt me vendimin nr.36, domethënë Këshilli ka vendosur dhe ka rënë dakord që të krijohet subjekti i kompetencave të përbashkëta që në këtë rast do të ishte i formës të një shoqërie tregëtare aksionere. Pas miratimit nga Këshilli i Bashkisë dhe miratimet në këshillat e bashkive të qarkut me përjashtim të Pogradecit u nënshkrua një marrëveshje me Ministrinë e Infrastrukturës. Tani vendimi i Këshillit të Ministrave parashikon që kjo marrëveshje duhet të kalojë për miratim nga Prefekti, por Prefekti në kompetencat e tij nuk ka thjesht miratimin e një marrëveshjeje ku nuk është fare palë Prefekti. Atëherë kjo lind nevojën e një vendimmarrjeje në këshill që Prefekti të shprehet për lirshmërinë e marrëveshjes. Prandaj për këtë arsye është këtu ky material që këshilli bie dakord. Edhe një herë se këshilli e autorizoi nënshkrimin e një marrëveshjenë shkurt. U nënshkrua kjo marrëveshjeje dhe fare mirë mund të bjerë dhe dakord që është okay më këtë marrëveshjeje.

Këshilltar E.Petriti: Parimisht e dhamë okay, tani nuk mund të japim okay për një gjë që dhamë okay. Po në qoftë se Pogradeci nuk përfshihet, çfarë bëhet?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Pogradeci është tjetër ujësjellës rajonal, është me Prrenjasin dhe Librazhdin, ose vetëm me Prrenjasin mos gaboj. Tani përtej këtij diskutimit ligjor që mund ta bëjmë ajo që duhet të themi është që është një projekt vendim që ne po e sjellim për miratim në kuadrin e një vendimmarrjeje të një diskutim që e kemi bërë para disa muajsh ku kemi rënë dakord ta miratojmë në parim lidhur me këtë procedurën e krijimit të këtij subjektit të kompetencave të përbashkëta, dhe atëherë i kemi bërë të gjitha këto diskutimet dhe shqetësimet e drejta mendoj unë të disa prej këshilltarëve që kanë thënë okay ujësjellësi i Korçës është një ujësjellës që ka performancë të mirë edhe falë një menaxhimi të mirë edhe falë kulturës qytetare të Korçës për të paguar tarifatat. Pra është një ujësjellës i suksesshëm dhe mbase duke u bashkuar me disa ujësjellësa të tjera mund të rrezikohet performanca e tij. I kemi thënë të gjitha këto. Patjetër që është një proces që ka sfida por është një proces në të cilin ne po hyjmë me vetëdije për të ndarë atë eksperiencën tonë pozitive, por dhe për të qënë pjesë e kësaj reforme që po bëhet në sektorin e ujit, ku krahas asaj që do japim eksperiencës etj, edhe do të marrim pasi kusht i qeverisë për të vashduar mbështetjen në sektorin e ujit për nevojat e tjera që ne kemi për pjesën e kanalizimeve për shembull në zonën e fshatrave që i kemi copë copë për hir të së vërtetës, ka qënë që të jemi pjesë e këtij projekti dhe nga ana e llogjikës ekonomike ajo qëndron. Pra ekziston ai koncepti i ekonomisë të shkallës ku sa më i madh të jetë një subjekt aq më të ulta janë një pjesë e kostove, kostot administrative për shembull stafi, inxhinier teknik. Njëlloj sikur ta kesh 5 klient dhe duhet të kesh inxhinierë, edhe po ta kesh me 200 klient përsëri duhet të kesh inxhinierë. Pra efica e përdorimit të burimeve në këtë konceptin e ekonomisë të shkallës rritet si efica kur këto subjekte pra shoqëria në fjalë ka një masë të caktuar. Sfidat janë të mëdha, procesi është i rëndësishëm, por unë besoj se do t'ja dalim me sukses duke mbajtur parasysh edhe ato që kanë qënë vërejtje, votat e këshilltarëve. Pra të mos priset performanca e ujësjellësve të bashkisë së Korçës, të mos duhet që klientët pra banorët e Korçës të mbajnë kostot dhe të paguajnë për shërbime që duhet ti paguajnë banorët e bashkive të tjera që do të bëhen pjesë e këtij ujësjellësirajonal. Tani janë të gjitha shqetësimet që i kemi patur parasysh dhe do ti kemi në të ardhmen, i kemi ngritur në të gjitha diskutimet edhe me AKU-në edhe me Ministrinë dhe janë gjëra që do të adresohen dhe do tëmbahen parasysh. Sot është një hap procedural në vashdim të

kësaj procedure që ne kemi filluar dhe e kemi miratuar këtu në këshill. Është një hap procedural ku marrëveshja që ne kemi nënshkruar , si kryetar bashkie me ministrinë duhet të kalojë dhe në këtë ratifikim në Këshillin e Bashkisë. Këto detajet ligjore i shpjegon Anxhela, por nuk është shumë e rëndësishme besoj unë që të ndalemi shumë në detajin ligjor sesa në vetë procesi dhe pikësynimi ku kemi hyrë. Ajo është më e rëndësishme besoj, pastaj ana ligjore është çështje e juristëve.

Këshilltar E.Petriti: Ky proces dhe pikësynim nuk buron nga Bashkia Korçë. Ky proces dhe pikësynim është në vargun e disa VKM-ve për centralizimet etj etj. Ministria e Ekonomisë dhe e Energjitikës do tëlikujdojë 51% të aksioneve që do të përfitojë. Nëse do të mbyllim shoqërinë me 10,000,000 lekë, Ministria e Ekonomisë do të ketë 51%.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Ja ta shpjegoj patjetër. Pra ideja është që kjo është një shoqëri aksionere dhe aksionet janë ndarë 51% i ka Ministria e Infrastrukturës dhe pjesa tjetër 49% janë ndarë ndërmjet 5 bashkive pjesëmarrëse në këtë SH.A, bazuar mbi numrin e klientëve. Bashkia e Korçës ka 29%, bashkitë e tjera kanë gati 8% nuk më kujtohen, pra është ndarë ky 49%, pastaj ajo marrëveshje po ta lexosh flet për pjesën se si do të kontribuojë qeveria pra Ministria e Infrastrukturës në këto 51%.

Këshilltar E.Petriti: E ka përcaktuar ligji këto 51% me të drejta dhe detyrime. Nuk mundet tani VKM-ja të dalë mbi ligji, e në qoftë se kjo kompani do të dalë fituese Ministria e Ekonomisë do të marrë 51% këta do ndajnë 49%. Nëse do të dalë humbëse është e njëjta dhe këto do të paguajnë 28.9% Bashki e Korçës.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Pyetja që bëre pak më përpara kishte lidhje me punën e ekspertit financiar të themi që do të bëjë këtë mënyrën e likuidimit të aksioneve në kuptim qeveria ka 51% të aksioneve.

Këshilltar E.Petriti: Nuk ka likuidim , sepse kush ka 51% zgjedh anëtarët e këshillit mbikqyrës, se ka të drejta dhe detyrime.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Tani ja më dëgjo, fillove të lexoje më përpara atë nenin për mënyrën se si do kontribuojë qeveria në këtë 51% të aksioneve.

Këshilltar E.Petriti: Do kontribuojë 51% të aksioneve , dhe 51% do të ketë paketën dërmuese të aksioneve.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Patjetër, domethënë do ketë një këshill mbikqyrës SH.A-ja ku do jenë të përfaqësuar të gjitha bashkitë që kanë mbi 12% aksione se kështu e ka ligji i shoqërive tregëtare dhe vendimmarja në këshill do të jetë që ata anëtarë që do të përfaqësojnë mazhoritar . Po kanë mazhorancë patjetër si një organizim të një shoqërie tregëtare. Ajo që është e rëndësishme të themi është kjo, që po e shohim tani nga krahu tjetër, nga krahu i përfitimit. Qeveria angazhohet që të mos ketë vetëm 51% të vendimmarjes po të ketë dhe 51% të detyrimeve që do të thotë është angazhuar që këtë pjesëmarrje në aksione ta shlyejë nëpërmjet

kontributeve për projekte në të ardhmen. Pra do financojë qeveria në këtë sektorë, do ti llogariten në pjesën e aksioneve.

Ekzekutivi A.Dishnica: Janë 3 lloje: në shërbime, në natyrë dhe në para.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Domethënë nuk është se qeveria po hyn, se duhet ta sqarojmë këtë është një sektor që nuk është i konsoliduar tani, është fitimprurës dhe tani po na hyn qeveria dhe po na merr 51% të fitimit. Është një sektor që në shumicën dërmuese të bashkive të vendit del me humbje, dhe edhe në bashki si kjo e jona dalim me fitim për momentin ka akoma shumë nevojë për investime të cilat ne i kemi të pamundur ti përballojmë me buxhetin e bashkisë. Për shembull një nga sfidat tona kryesore është adresimi i projektit të kanalizimeve për zonën rurale, i kemi fshatrat copë copë. Në fshatin më të mirë mund të kemi ndonjë rrjet të pjesshëm të kanalizimit të cilat shkarkohen në mjedis pa asnjë lloj trajtimi. Pra duam investime në rrjet, duam investime në impiantet e trajtimit të ujrave të përdorura. Kemi bërë një projekt ide me kompaninë ujësjellës kanalizimeve dhe vetëm për grupin e fshatrave kryesore të bashkië që kanë edhe pjesën më të madhe të popullsisë arrin në 12,000,000 euro. Ka mundësi tani, po aq shkon kanalizimi bashkë me impiantet e trajtimit. Ta bësh me standart, sepse hapen negociatat me BE, nuk pranon një vend europian që ti ti shkarkosh ujrat e zeza në kanali vaditës apo kullues që kalon atje në arra afër fshatit. Duhet të plotësosh standartet dhe plotësimi i standarteve do investime, të cilat ne nuk i përballojmë dot që të flasim realisht tani.

Këshilltar E.Petriti: Bashkia ka paguar investimet e ujësjellësit dhe kanalizimit të Korçës.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Atëhere ujësjellsi i Korçës pjesërisht është grant, pjesërisht është kredi e cila po paguhet tek KFV-ja nga konsumatorët, pra nga qytetarët, ndërkohë kanalizimet janë pjesërisht grant dhe pjesërisht kredi dhe peshën e kredisë për momentin po e mbulon qeveria, sepse që ujësjellësi të jetë në gjëndje të paguajë kredinë duhet të rritë shumë tarifat të cilat nuk mund ta bëjmë. Pra qeveria është angazhuar dhe ka thënë që unë me mbështetjen time për këtë sektor që realisht ka qënë shumë e madhe, për shembull në dy prej viteve të fundit janë bërë investime shumë të mëdha në pjesën e ujësjellësave në fshatra. Dhe ne kemi investuar si ujësjellës në 14 fshatra, ndërhyrje nga të pjesshme të vogla deri në të plota. Qeveria është angazhuar që këtë mbështetje ta vazhdojë edhe në të ardhmen për pjesën e kanalizimeve, po ka thënë me të drejtë, dhe unë po të isha në vendin e atyre këtë punë do bëja, nuk mund të vazhdoj të investoj në sektor i cili është një gropë e zezë i cili vetëm thith fonde dhe nuk shkon asgjëkundi, dhe me të drejtënga analiza njëra prej arsyeve sepse është në këtë gjëndje, është sepse ujësjellsat duke qënë shumë të fragmentizuar kanë qënë të keq menaxhuar. Kanë qënë të keq menaxhuar si subjekte të ndryshme të të gjitha formave, dhe duke bërë këtë reformë, duke i zmadhuar edhe rritet efienca edhe rritet një lloj kontrolli mbi performancën dhe mbi mënyrën se si operojnë ujësjellsat. Ne kemi qënë model suksesi por mjafton ky fakt që ne akoma kemi nevojë për investime shumë të mëdhaja të rendi 12.000.000 euro që ne të gjithë të mbrojmë të dyja duart dhe të hyjmë në këtë proces qofte dhe nga fakti që na hapet rruga për të siguruar këto financime të nevojshme për zonën rurale. Patjetër duke pasur vëmendjen që në këtë proces interesat e komunitetit të bashkisë të Korçës, të qytetit kryesisht por dhe të fshatit të mos çënohen, pra të mos bëhemi ne ndërrmarje në thonjza që paguan edhe për të tjerët që mund të

jenë mësuar të mos paguajnë. Jo të gjithë do jemi në standartin e Korçës, që për hir të së vërtetës është përmendur si model i suksesshëm, pra duhet edhe të tjerët të mendojnë në dy drejtimet, të presin kostot e pa nevojshme dhe të rritin të ardhurat, sepse ky ujësjellës nga pikëpamja financiare do funksionojë me qëndra kostoje, pra nuk është se do bëhet një ujësjellës i madh ku hyjnë të tërë dhe nuk merret vesh. Çdo bashki do të ketë një sektor të sajën që nga pikëpamja e financave do të funksionojë si një qëndër kostoje e vecantë që duhet të dalë 0-0, jo të dalë minus edhe të na rëndojë ne.

Këshilltar E.Petriti: Kështu do jetë?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Po kështu do jetë patjetër.

Këshilltar E.Petriti: Nuk do jetë që do performojnë ata mirë, do jetë që ujësjellësi i Korçës, ne kemi një model shumë të mirë me ujësjellsin e Korçës dhe Pogradecit. Më ngjason me këtë hartën gjyqësore. Shiko kam të drejtë të flas, dhe do them qëndrimin tim. Më ngjason me hartën gjyqësore që është më mirë të kemi një njësi të madhe që ti menaxhojë sepse është ekonomia e shkallës me fjalë të tjera. Dhe me ekonominë e shkallës e pamë që nga ndarja territoriale për ekonominë e shkallës të ulë shpenzimet etj etj, janë rritur shpenzimet të paktën dyfish nga administrata, e njëjta gjë është dhe kjo. Këtu është një ide e Kryeministrit, ose është një nuk e di një perceptim i gabuar, dhe ta garantoj kryetar që të gjithë atë do ta ketë qyteti i Korçës, sepse ato nuk kanë as rrjete ato nuk kanë as kapacitete për ti realizuar këto dhe është shumë e vështirë që në Pogradec ose në Kolonjë të ketë të njëjtën performancë siç do ketë në Korçë. Kryetar mendon se kjo është mënyra më e mirë që ky sektor të jetë sektor të rimëkëmbet në këtë formë, apo është që do të merrë në qafë ujësjellsin e Korçës.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Jo absolutisht që s'ka njeri qëllim që të marrë në qafë ujësjellsin e Korçës. Ideja është që këtë model të suksesshëm që e thonë të gjithë dhe që s'është bërë këtu me meritën time, se ujësjellsin i Korçës është bërë që në 2003 dhe ka performuar mirë edhe para se unë të isha edhe zv kryetar edhe kryetar i bashkisë. Meritën kryesore duhet t'ja japim Çezarit atë që i takon, e kanë qytetarët e Korçës për hir të së vërtetës. Kyresoren e kanë qytetarët e Korçës që kanë pasur vetëdijen që një shërbim i mirë lidhet me një investim të mirë dhe më të madh, dhe një investim më i madh duhet paguar mbrapa nga tarifat. Pra ideja është jo të prishim ujësjellsin e Korçës, po këtë model të suksesshëm ta replikojmë. Tani për të erdhur në faktin që pse qeveria po hyn aksionere. Qeveria mendoj unë, po të isha në vendin e tyre dhe kjo ka qënë llogjika, me gjithë qejf do ti linin ujësjellsat të menaxhoheshin nga bashkitë, por në kushtët kur qeveria pavarësisht se ujësjellsat janë menaxhuar nga bashkitë është detyruar sistematikisht në vite që të kontribuojë shuma të mëdha financiare të cilat nuk e kanë justifikuar pastaj me performancë dhe thotë unë po hedh që po hedh lekë atëhere të hyj edhe aksioner që të mirë menaxhoj lekët që po fus, sepse nuk është se po vjen dhe po menaxhon buxhetin tonë, Korça okay por po flasim për ujësjellsat e tjerë që financohen më miliona euro në vit për kosto operationale. Tani që të mos zemë shembuj dhe nga ana e llogjikës ekonomike unë ju jap të drejtë, procesi është i drejtë, ajo që ne duhet të marrim, se e kam përsëritur 100 herë këtë gjë, është që të kujdesemi që brenda këtij procesi, interesat e qytetit dhe të bashkisë të Korçës të mos cënohen, këtë do ta bëjmë patjetër.

Këshilltar E.Petriri: Kapitali i ujësjellësit të Korçës në dijeninë time i kalon 10,000,000 lekë. Domethënë do të krijohet një shoqëri me 10,000,000 lekë, shoqëria do të krijohej nga shumatorja e kapitaleve të të gjithë ujësjellsave plus të tjera, dhe janë lloj lloj kontributesh nënatyrë shërbime, bilanca. Tani kur të nisë kjo shoqëri do fillojë me një kapital prej 10,000,000 lekë.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Unë nuk kam asnjë lloj vërejtje që të respektojmë tërësisht rregulloren, që të mos jetë kështu bashkëbisedim, por meqënëse Miri u bë kohë që nuk ka ardhur. Unë kam 3 pyetje: e para vlera në lekë a në euro s'ka rëndësi e kapitalit të shoqërisë ujësjellës kanalizime Korçë sa është?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Aktualisht?

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: E dini sa është? Se ju do shtoni 28.5% atje. Tani ky 28.5 pjesë e kujt është se nuk është 28.5 pjesë e 10,000,000. Ky është kapital themeltar i rregjistruar , po ne hyjmë jo thjesht me tubot që kemi të shtrirë në rrugë apo me depot e ujit, po hyjmë dhe me asetet njerëzore, është investuar atje që janë ata inxhinierë, që është ai staf që shërben, është investuar për shumë vite, kanë ikur nëpër trajnime, kanë ikur nëpër konferenca, janë trajnuar mirë për të qënë atje. Tani unë këtë dëshirën për të marrë investim nga qeveria dhe e kuptoj, në kuptimin që po të ishte që të mos çante kokën do thoshte , mirë jeni kështu të ndarë, por të bashkojë dhe të merret me ata që kanë probleme, jo ne që ishim në rregull kemi nevojë patjetër dhe e ka detyrim ligjor që të kujdeset dhe për këtë popullsi. Ne siç investuam 30,000,000 euro nga sa kanë vajtur deri tani nuk është problemi i madh, edhe madje dhe me i madh se ato 12 të tjerat. Me të njëjtën skemë di që edhe faturohen tani detyrimet, se i kishin 2 lloj këstesh ato 25 vjeçare dhe 40 vjeçare. Një pjesë plotësohen, ne jse ky është qëndrimi im, unë këtë material e ripërsërit që edhe herën e kaluar nuk e kam votuar se shqetësimin tënd e kuptoj, nuk është se dallojmë, thjesht qëndrimet, ti për shkak të angazhimeve që ke mund ta kesh pak më të ndryshëm. E thashë kështu si me fjalë të shkëputur po besoj e kuptuat këtë gjë. Kjo është e para, e dyta a janë përcaktuar kriteret kur kjo nuk funksionon dhe është lënë një dritare, ore ne këtu po kërcënohemi si do të veprojmë. Po supozojmë që bashkuam tani, ne kemi ujin 24h, ndërmarja është e shëndetshme, shlyhen detyrimet, ka personel të kualifikuar për të shërbyer. Ndodhi bashkimi , u çorientua gjëja, ne si do e matim këtë, se ne nga aksionerë kryesor apo i deleguar siç jeni ju me ndryshimet kur janë bërë para disa viteve, kalojmë një aksioner i dytë në këtë rast, po që aksesin në informacion nuk e kemi dhe që funksionon kjo ndërmarje e the shumë bukur është merita e qytetarëve po edhe e këtyre institucioneve që janë treguar të përgjegjshëm, dhe asaj administratës atje që ka performuar, se në Korçë jo të gjithë gjërat kanë funksionuar, pavarësisht që edhe dritatat janë paguar këtu po s'ka qënë performanca aq e mirë saç ka qënë për ujësjellsin sepse kemi zona ne megjithëse kanë kaluar kaq shumë vite, janë pa energji, ja një zonë është Opari , për mua unë e di e kuptoj dhe atë pozicionin tënd të vështirë që je midis dy, asaj që vërtet dëshiron dhe këtyre që po diskutojmë ne dhe asaj që është një gjë më e madhe se ne, po meqënëse ju jeni marrë me detaje, a ka një dritare këtu . Si ta kuptojmë ne që po respektohet dhe nuk po çënohet interesi i publikut të Korçës? Këtë si do ta matim? Dhe e treta a është menduar ndonjë proces invers se ne kuptohet të ndikuar pak nga vullneti politik i përgjithshëm po i votojmë këto si

këshill. Pra pavarishtë vullnetit dhe dëshirës që secili ka këtu për të mbrojtur interesin e publikut që në fund të fundit është interesi ynë direkt se shkojmë në shtëpi, njëherë na ndodhi që nuk kishim ujë për shkak të një difekti dhe u alarmuam sepse në shtëpi nuk kishte një gotë ujë të pije, e kemi pirë nga çezma kështu funksionon prej shumë vitesh. Tani ky standart që është më i miri që është arritur në Shqipëri, që e kanë zili dhe vendet fqinje, si në rast se ndodh një gjë, është menduar ndonjë proces invers që të kthehem ku ishim se ishim mirë. Këto janë 3 gjërat që unë i kam të domosdoshme.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Atëhere po i përgjigjem këtyre pyetjeve si i kuptova unë. E para është njëqështje shumë teknike që lidhet me një ekspert që do të bëjë konsolidimin e këtyre bilanceve. Pra ideja është qëkjo barra e % të kapitaleve nuk është bërë bazuar mbi vlerën e aseteve të x ujësjellsis apo të y ujësjellsis, është bërë bazuar mbi numrin e lidhjeve, pra ndarja e % të aksioneve, Ministria ka mbajtur 51% pra kuoten vendimmarrëse dhe 49% janë ndarë në bazë të numrit të lidhjeve, Korça 28% ato të tjerët thashë të ndryshme tani se nuk i mbaj mend. Dhe për këto detajet financiare se nuk jam ekspert, po ta shikoni edhe ne marrëveshja thuhet që do të angazhohet një ekspert që do të bëjë konsolidimin e bilanceve. Në atë moment mund ta thërrasim ekspertin dhe të bëjmë edhe një sesion këtu në këshill që t'i japë përgjigje pikës se si është bërë konsolidimi i bilanceve të 5 shoqërive, e para. E dyta nuk është se ne nuk jemi pjesë e organeve të shoqërisë, jemi pjesë e të gjitha strukturave të shoqërisë, duke filluar nga asambleja e aksionerëve ku është anëtar kryetari i bashkisë dhe i bashkive të tjera dhe përfaqësues nga ministria, kjo është asambleja e aksionerëve, pastaj vijmë në këshillin mbikqyrës ku kemi përsëri anëtarë, pastaj vijmë në organet e shoqërisë që është administratori që do përcaktohet nga këshilli mbikqyrës njësoj si për çdo shoqëri tregëtare dhe, edhe në këshillin mbikqyrës kemi anëtarë që ka detyrime të na informojë se çfarë ndodh në shoqëri, dhe në asamble na informon ose kryetari i bashkisë që përsëri do njihet me raporte periodike edhe për buxhete, listë investimesh, prioritete investimesh, të gjitha do të jenë të informuara, jemi pjesë e shoqërisë nuk është se po na thonë mos hajdeni mëdhe vetëm kur duam t'ju themi ndonjë gjë dhe do ja u themi. Pyetja e tretë procesi, në rast se ekziston ndonjë mundësi për të dalë nga kjo inisiativë ku po hymë, besoj se përgjigjia është në ligjin për shoqëritë tregëtare.

Ekzekutivi A.Dishnica: Në marrëveshja është përcaktuar për një periudhë 10-vjeçare.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Po, mirë okay për një periudhë 10-vjeçare nuk dalim dot. Kjo është mënyra e funksionimit, është ligji i shoqërive tregëtare dhe kjo marrëveshje. Megjithatë thashë nuk është qëllimi të keqësohet performanca e ujësjellsit të bashkisë të Korçës, përkundrazi ideja është të përmirësohen të tjerët, se kush ka interes të prishë një model të mirë, të suksesëshëm, asnjë njeri nuk ka interes.

Këshilltar E.Petriti: Druri i shtrembër mbetet druri i shtrembër, nuk drejtohet. Dhe këtë rradhë kam përshtypjen që jemi në këtë që druri i shtrembër të prish stivën.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Tani tjetër është qëllimi i mirë dhe tjetër si dalin rezultatet. Të biem dakord kryetar që nuk u bë nga Berisha para 10 viteve me qëllim të keq privatizimi i Çez-it, por ja që na zhyti 1,000,000,000 euro si shoqëri. Si shtet pati një kosto 1,000,000,000 euro dhe unë pavarësisht optimizmit që më karakterizon e gjërat e mira, prapë lind e drejta që të mendoj, se është mirë, po të ishte keq do të thesha hajde ta provojmë çfarë humbim, nuk humbim asgjë, ta provojmënes'kemi qës'kemi ujë, mbase do kemi 2 orë në ditë ujë më shumë po në kushtet që ne e kemi 24h unë nuk pretendoj dot 36h, 24h mirë e kam, të pastër e kam,e konsumoj e paguaj.

Këshilltare I.Nikaj: Unë doja të ndalesha këtu që kam ndjekur një komisionin të Kuvendit, atje u tha që ujësjellsit i Korçës ka koston më të lartë në Shqipëri për pikë kontakti. Pra çfarë do të thotë kjo për mua, që të gjitha këto investime të tjera do të rrisin kostot që ne do të duhet të paguajmë. Ajo që mendoj është që qytetarët Korçarë kanë paguar shumë, unë mendoj që ata duhet të kenë një lloj lehtësime. Do të ishte shumë e arsyeshme që ata ose të gjenin një lloj stabiliteti, sepse kjo mund të sjellë shtrenjtim të pagesave që do të bëjnë qytetarët Korçarë nëse mendohet që këto investime në ato pika që do të krijohen do të krijojnë atë 0-0. Pra mendoj që edhe në atë që është vepruar më parë, pra kostot do i shkojnë qytetarit e para, e dyta burimet njerëzore çfarë do të bëhet me to, sepse nëse shumicën do ta ketë një 51% çfarë do të vendosë për atë që është shqetësimi në nivelin vendor ? Dhe ajo ajo që kam pyetje është, a është ndonjë nga këto shoqëritë e krijuara që shumicën e ka qeverisje vendore?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Po e filloj nga kjo e fundit, jo. Domethënë skema është e njëjta, në çdo ujësjellës rajonal që po krijohet 51% e ka qeveria dhe 49% e aksioneve ndahen ndërmjet aksionerve të tjerë që janë pjesë e këtij ujësjellsit rajonal. Përsa i takon pikës të parë jemi në nivelin e spekulimit, se skema pse themi që ky proces do çojë në rritje të tarifave që do të paguajnë qytetarët, nuk bëhet fjale për këtë, bile e kundërta qëllimi i këtij procesi është rritja e efikasitetit të përdorimit të fondeve. Pra menaxhim i mirë i kostove, menaxhim i mirë i strukturave, organizim i praktikave pra në rast se kot po them ujësjellsit i Korçës ka 2. ca punonjës kot po them për 1000 lidhje, kjo do merret si standart dhe të aplikohet me ujësjellsat e tjerë. Pra ideja e procesit është rritja e efikasitetit të përdorimit të fondeve që ujësjellsat gjenerojnë nga të ardhurat që mbledhin, të përdorë edhe nga ato që ju ka dhënë dhe do ju japë qeveria si subvencion, se dy janë burimet e buxhetit e një ujësjellsit: të ardhurat që mbledh vetë dhe subvencionin që merr nga qeveria. Ata që kanë marrë edhe kredi kanë pasur edhe kredinë, këto janë. Tani ideja është ta rritim efikasitetin e këtyre fondeve, pra mos ikin përpara punonjësish pafund në x ujësjellës por të përdoren me ekonomi dhe të ketë një kontroll , kjo është ideja. Pyetja e dytë cila ishte ma kujto dhe njëherë.

Këshilltare I.Nikaj: Për burimet njerëzore.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Në kuptimi?

Këshilltare I.Nikaj: Në kuptimin e atyre që janë, çfarë do bëhet me ta.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Burimet njerëzore do të qëndrojnë në kompani patjetër, nuk është se do marrim njerëz të tjerë dhe do ti sjellim të punojnë në Korçë. Ato burime njerëzore që janë aktualisht ata do jenë në punë. Nuk është se do ikin të gjithë dhe do të vijnë nga një qytet tjetër këtu. Ata burime njerëzore që janë do të vazhdojnë.

Këshilltare I.Nikaj: Pra efienca nuk parashikon rritje çmimi?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Po patjetër, ideja është që ato lekë që kemi ti përdorim në mënyrën më eficiente dhe të mos i shpërdorjmë në kuptimin për gjëra që mund të përdoren më me kursim. Nuk është ideja të prishim atëherë sesa prishim tani për të njëjtën mënyrë të ofrimit të shërbimit. Ideja është ta bëjmë në mënyrë më eficiente ofrimin e shërbimit, të kursejmë lekë që ti përdorim për ta përmirësuar akoma më tepër shërbimin, është e kundërta. Procesi synon të kundërtën, pra rritjen e efiençës dhe përmirësimin e shpenzimit, në mënyrën se si e shpenzojmë buxhetin e ujësjellsit. Mirë bëmë që e bëmë këtë diskutimin se i vlen edhe këshilltarëve edhe publikut, por duhet ta vendosim njëçik edhe në kontekst të procedurës që kemi ndjekur. Pra e kemi miratuar këtë projekt në mbledhjen e para disa muajve, tani jemi që po diskutojmë marrëveshjen jo thelbin e procesit. Nuk jemi në momentin që të diskutojmë do hyjmë apo s'do hyjmë në këtë projekt, sepse këtë vendim e kemi marrë dhe në rast se dikush ka abstenuar në atë moment, se ka pasur me të drejtë ato dilemat që mund të kishin e të tjerët, tani nuk besoj se është arsye që po të jetë abstenuar në atë moment të abstenohet edhe tani, sepse tani jemi në një moment që po shohim marrëveshjen. Pra diskutimi është për marrëveshjen. Po e japim këtë informacionin edhe për të sqaruar këshilltarët edhe për të sqaruar publikun, por jemi në një moment tjetër të ecurisë.

Këshilltar J.Kodra: Në kuadër të kësaj që tha kryetari i bashkisë unë personalisht kam votuar kundër, po duke qënë se hymë në terma konkretë unë do të dalem në neni 6 paragrafi i parë ku thotë: Kapitali fillestar i shoqërive është 10,000,000 lekë. Dhe tani këtu na hyn në skenë Ministria me 5,1,000,000 lekëmerr 51% të aksioneve, ndërkohë që pikë referimi për 28.9% të aksioneve që ka Korça merr vetëm numri i abonentëve dhe 100,000,000 euro investime hidhen në plera. Kush e ka bërë këtë? Ju kenë qënë prezent zoti kryetar? Tani i jepni Ministrisë 5,1,000,000 me 51% të aksioneve dhe vlerësohet vetëm numri i abonentëve për të vlerësuar aksionet e bashkisë Korçë, ndërkohë që këtu janë hedhur investime pafund, në dijeninë time 100,000,000 euro, që po i paguajmë ne si taksapagues. Unë nuk e di si është kjo llogjikë në termat e ekonomisë, pastaj në ligjore është tjetër punë, por që të dorëzohesh me një performancë spektakël pozitiv të ujësjellsit të Korçës dhe të bazohesh në këtë vlerë 28.9% vetëm duke marrëparasysh numrin e abonentëve unë nuk arrij ta kuptoj. Hedhim tërë këto investime në plera dhe dorëzohemi i japim 51% të aksioneve Ministrisë.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Metodologjia e përdorur bazuar në numrin e aksioneve, nuk e di pa patur vlera është si llogjikë ekonomike, unë flas dhe nga biznesi në fakt, nuk e di nga ana juridike mund ta shpjegojë dhe Anxhela.

Këshilltar J.Kodra: Ajo nuk ka logjikë as ligjore, asetet vlerësohen 0.

Këshilltar E.Petriti: Të gjitha asetet e saj në këtë kuadër, në këtë shoqëri tregëtare të madhe se s'do quhet shoqëria A,B,C,D,E është një . Vjen ministria me duar në xhepa dhe merr 51% të aksioneve s'fut asgjë sepse do na informojë do na iluminojë. Nuk ka sens, ose është gabim kjo pastaj kapitali fillestar që duhet të marrim, shumatorja e të gjitha shoqërive aksionere dhe kjo është llogjika dhe ekonomike dhe ligjore.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Ky kapitali fillestar nuk përputhet me vlerën e aseteve të kompanive, se vlera e aseteve të 5 kompanive.

Këshilltar E.Petriti: Këtu është hilja kryetar, sepse ti hyn me 100,000,000 euro dhe ke 22%, mund ti vesh buzë dhe makiazh sa të duash , kjo punë ka një direksion nga kryeministri do ta firmosësh dhe kaq.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Atëhere se po hyjmë në një debat financiar që mund ta konsumojmë në momentin që do të caktohet ai eksperti.

Këshilltar E.Petriti: Kur të vijë eksperti do ta miratojmë, çfarë miratojmë ne tani? Miratimin e miratimit?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Mund të them 3 fjali rresh. Pra ideja është që këto pyetje i takojnë atij ekspertit financiar që do të bëjë konsolidimin e bilanceve. Kapitali fillestar nuk përputhet me asetet e kompanive. Ministria dhe kjo është politikë, ka mbajtur paketën kontrolluese 51% , mund të ishte 55% 60%, pjesa tjetër e aksioneve janë ndarë bazuar mbi numrin e lidhjeve që unë mendoj është e drejtë sepse po të merreshe vlera e investimeve për shembull mund ti binte që ujësjellsit në qarkun tonë , se e njoh disi situatën, Bashkia e Kolonjës mund të kishte më tepër aksione sesa Bashkia e Maliqit për shkak se këto vitet e fundit ka marrë shumë investime. E kam bërë këtë diskutim me drejtorin e ujësjellsit kur ishte me vend diskutimi dhe i kam thënë çfarë do marrim? Për mua më ideale do ishte një sistem që ponderonte edhe numrin e abonentëve edhe vlerën e aseteve, që i ponderonte në një mënyrë të caktuar dhe nga këto nxirrte % , por dhe fakti që ka shkuar thjesht me numrin e abonentëve është okay, se po të merreshe vlera e investimeve e aseteve do kishte disbalanca jo të logjikshme. Tani pse po e merr qeveria këto 51% dhe çfarë do na japë në këmbim? Ke pikën 7 të nenit 6 . Atëhere ta lexojmë pikën 7 shlyerje e vlerës minimale të aksioneve që do të zotërohen nga ministria infrastrukturës dhe energjisë do të kryhet duke mbyllur investimet në proces që janë financuar nga buxheti i shtetit dhe me anë të investimeve

kapitale qeveria do të ndërmarë në vitet në vijim në shoqërinë rajonale të ujësjellës kanalizime Korçë. Pra nuk është se po të merr paketën e aksioneve dhe po të thotë s'do të jap asgjë, jo do llogariten, ke marrë kaq investime do marrësh edhe kaq investime derisa ne të shkojmë tek kjo vlera 51%. Ke dhe pika të tjera këtu tani qëti hyjmë anës financiare.

Këshilltar J.Kodra: Se mos bëhet kështu që derisa të arrijë ajo 51% e investimeve e kupton?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Sepse kjo punë është pula vezën apo veza pulën dhe ta shpjegoja që qeveria ka investuar shumë lekë në sektorin e ujësjellësit dhe këtu po perifrazoj atë që kam dëgjuar nga kryeministri kur na ka mbledhur ka thënë: Kemi investuar shumë lekë nga buxheti i shtetit për këtë sektor dhe nuk kemi marrë nga mbrapa atë. Atëhere në dy vitet e fundit janë investuar në këto 14 ujësjellsat e fshatrave .

Këshilltar E.Petriri: Në ujësjellsi i Korçës.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Pjesë e ujësjellësit të Korçës, në fshatrat e Bashkisë së Korçës në 2 vitet e fundit, se që nga 2015 fshatrat e Bashkisë së Korçës administroheshin nga ujësjellësi i Korçës, jane investuar 100,000,000 lekë të reja në 14 ujësjellsa me kontribut nga bashkitë e tjera është investuar shumë më tepër dhe ajo që ka thënë kryeministri është kemi investuar shumë dhe rezultatet nuk janë ato që kemi pritur, bile ka ndodhur edhe fenomeni shumë i çuditshëm që është ujësjellësi i ri, janë investuar lekë dhe performanca është përkeqësuar, jo vetëm që nuk është rregulluar por është përkeqësuar.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Kryetar ke shumë të drejtë për këtë pjesën e shëmbujve që sjell, por gjithëmonë diskutimi këtu është për raste konkrete. Se rasti konkret që ne kemi është krejt i ndryshëm nga gjithë situata në Shqipëri, nuk ka lidhje fare me Shqipërinë. Na shikojnë për këtë ngandonjëherë me dashamirësi, nga ndonjëherë me zili dhe na thonë me keqdashësi se ju të Korçës keni ujë 24h. Tani në familjen tënde dhe timen paguajmë nga 15-20, paguajmë më shumë se kudo tjetër. Shifra që akoma dhe sot që ne flasim me këtë inflacion të jashtëzakonshëm që është, shifra që nuk i janë afruar akoma as ujësjellsi i Tiranës , as ujësjellësit e tjerë nga shifrat që paguajmë ne. Tani diskutimi im është dakord u ra dakord nga ky këshill nga ju që ne të jemi pjesë e kësaj, sot që po miratojmë këtë ka mundësi nga ana teknike që ne këtu të shtojmë pika me Anxhela në kjo marrëveshja, se ne po hyjmë, po hyn qyteti, bashkia. Nesër unë nuk do jem këtu në këtë këshill, kryetari i bashkisë mund të mos jetë kryetar bashkie.

Ekzekutivi A.Dishnica: Nuk ndryshojmë dot asgjë sepse është marrëveshje.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Atëhere pse e lini të miratohet, se është kështu kjo jeni dakord s'jeni dakord se ne e duam kështu të bëhet kjo. Tani cili është diskutimi atëhere. Kështu është kjo

do e bëjmë kështu? Që edhe kjo neni i bërë standart si për Pali Poleskin ne Postec, dhe për Sotiraq Filon në Korçë.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Tani nga ana ligjore unë nuk jam jurist , por unë di të them këtë gjë që para disa muajsh e kemi bërë diskutim me të gjitha këto që po themi, mbase edhe me ndonjë gjë më tepër dhe e kemi marrë këtë vendim për të hyrë në këtë proces dhe për të autorizuar kryetarin e bashkisë që të nënshkruajë marrëveshjen bazuar dhe mbi vendimn e këshillit të ministrave që doli për këtë punë. Unë me këtë autorizim e kam nënshkruar këtë marrëveshje. Tani po vijmë për ratifikimin e kësaj marrëveshje, nuk është se jemi këtu të ndryshojmë dicka, por unë them që pikat që ka marrëveshja nuk është se sjellin ndonjë gjë që nuk e dinim në momentin kur kemi hyrë.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Nuk e dinim që do ishim aksionerë me 28% pa marrë në konsideratë vlerën .

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Që 51% do i kishte qeveria ka qënë që atëhere.

Ekzekutivi A.Dishnica: Ishte në Vendimin e Këshillit të Ministrave.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Po si do vlerësoheshe kjo?

Ekzekutivi A.Dishnica: Është më në detaje.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Më ne detaje më fal ne jemi 28% në 100,000,000 euro asete, ata me atë që do bëjnë në të ardhmen janë 51% dhe nesër një vendim i bordit që nuk ka fuqi fare kjo 28% të marrë pompat e Turanit për emergjencë ti çon në Leskovik se ka % ajo. Çfarë do bësh ti protestë? Këto janë raste ekstreme dhe qesharake por realisht kështu do të funksionojë.

Ekzekutivi A.Dishnica: 28% ky ekspert do ta përcaktojë nga se përbëhet.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: E kanë përcaktuar abonentët.

Ekzekutivi A.Dishnica:Eshtë për pjesëmarrjen në kapital nuk është për kontributin. Kontributi mund të jenë këto pompat që the ti që përbëjnë 28% dhe ndërkohë pika tjetër kalon direkt në bashki.

Këshilltar E.Petriti: Të lutem më bëj përkufizimin e fjalës kapital.

Ekzekutivi A.Dishnica: Po pjesëmarrja.

Këshilltar E.Petriti: Po me gjithçka.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Dakord ç'kishim për të thënë i thamë. Do ta hedhim në votim të ikim. Brënda kësaj janë dy vendime 2 pika: Një është që miratojmë këtë kontratën dhe një tjetër është që këshilli autorizon përfundimisht kryetarin e bashkisë për ta përfaqësuar në vijimësi për gjithçka.

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 21

Vota KUNDËR 2

Vota ABSTENIM 0

Pika 8 e rendit të ditës

PËR MIRATIMIN E PROPOZIMIT TË PRIVATIZIMIT TË DREJTPËRDREJTË TË PASURISË NR.204/7 ZK 2631, DHËNË ME QIRA SUBJEKTIT KORÇA GAS SH.A.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Komisioni i Çështjeve Ligjore u mblodh? Të lutem mund të thuash 2 gjëra shkurt.

Ekzekutivi A. Dishnica: Qëllimi i kontratës së qirasë ka qënë dhënia në administrim e në përdorim të kësaj pasurie, shoqërisë Korça Gas Sha, për ta përdorur si ambient funksional gjatë ushtrimit të aktivitetit të saj tregtar si vendosja e objekteve të ndryshme në sipërfaqe dhe bombolave të gazit dhe ngrohësive. Nga kjo shoqëri është paraqitur një kërkesë që me anë të saj kërkon privatizimin e truallit të dhënë me qira bazuar në legjislacionin në fuqi. Në kontratat e qirasë ose të enfiteozës, të lidhura për pasuri ku sipërfaqja e truallit është mbi 500 m2, në rastet kur shoqëria qiramarrëse ose enfiteozëmarrëse ka kryer investime në përpunje me planbiznesin dhe në masën mbi 150 për qind të vlerës së truallit, si dhe kur shoqëria ka respektuar kushtet e kontratës, subjekteve kontraktuese, që kanë konsumuar mbi 5 vjet të kontratës, u lind e drejta e privatizimit të drejtpërdrejtë të objektit të kontratës, sipas legjislacionit në fuqi. I propozojmë këshillit që të miratojë privatizimin e kësaj pasurie.

Këshilltar E.Petriti: Kam dy pyetje. Pikë së pari çfarë e pengon bashkinë të mos presë 10 vjet sa i takon qirasë po ta privatizojë, dhe e dyta asaj vlerës nënkupton çmimet minimale për sa i përket pagesës së kalimit të pronësisë sepse ajo mund të merret dhe një ekspert tjetër dhe sot mund ta ketë vlerën të paktën 3-fish, sepse siç ja rrit vlerën investimi tokës dhe toka në vetvete ka vlerë. Procedurat janë një mjet që të shkosh drejt një niveli, pse bashkia ta verë dorën në zemër në këtë rast në aspektin e bujarisë, se është platformë, kush do ta bëjë kërkesën mjafton të plotësojë kriteret ligjore dhe o burra t'ja shesim? Është një kriter financiar që bashkia mund të nxjerrë disa të ardhura më shumë, duke bërë vlerësimin një ekspert i fushës.

Ekzekutivi A. Dishnica: Po me ekspert vlerësues është bërë.

Këshilltar E.Petriti: E thashë edhe një herë ajo vlerë është e përcaktuar nga Këshilli i Ministrave , 15% të kalimit të pronësisë po 15% e paguam edhe sipas vlerës dhe nëse ajo ka një vlerë 3-fish më të madhe e paguan 3-fish dhe në këtë leverdinë e kemi që në bashki të hyjnë sa më shumë të ardhura jo të marrim ato vijat minimale dhe kot pastaj.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Domethëne ishin 2 pyetje, e para pse bashkia e ka marrë vendimin për ta propozuar këtë? Po jemi brënda përcaktimeve të ligjit e para dhe e dyta nuk kemi ndonjë interes si bashki për ndonjë zhvillim aty në atë pronë, ndërkohë ka një investim nga privatja që e ka marrë me qira, këto janë arsytet se pse e kemi sjellë.

Këshilltar E.Petriti: Kur i ka plotësuar?

Ekzekutivi A. Dishnica: Në 2019.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Përsa i takon pyetjes së dytë lidhet me vlerën, edhe për vlerën ne nuk jemi ekspertë vlerësues dhe ne mund të diskutojmë këtu si bisedë në kafene.

Këshilltar E.Petriti: Jo kafene sepse ne kemi në profesionet tona. Në qoftë se një proces del që duhet të vijë një person që ka njohuri të caktuara merret ai .

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Tani po them që mund të diskutojmë këtu jo po vlera është aq po mund të shiteshe aq, po shiko se atje ngjitur ishte ashtu nuk shkon gjëkund.

Ekzekutivi A. Dishnica: E ngatërruat këtë. Çështja është që llogaritja është dhënë për të përcaktuar a është 150% e vlerës së trullit jo se do shitet me këtë vlerë, se shitjet do të ngrëjë komision ministria e financave që do ta bëjë .

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Pra llogaritja është bërë se ligji thotë që këtë të drejtë mund ta ushtrosh pasi kanë kaluar 5 vite dhe po ke bërë mbi këtë objekt që ke marrë me qira një investim me vlerën 150% të vlerës së sendit që ke marrë me qira. Është bërë llogaritja e vlerës të sendit nga eksperti sipas ligjit që thotë ky vlerësim nuk bëhet nga njerëz të çfarëdo llojshëm por bëhet nga njerëz që kanë licencë si ekspertë vlerësues. Ata kemi marrë, kanë bërë atë vlerësim po e miratojmë këtë procedurë në parim këtu dhe le ta ndjekë pastaj Ministria e Financave për vlerën që do ti verë dhe sa do ta privatizojë.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Parimisht duke parë vendin ku është, unë kam merakun e precedentit. E kemi dhënë në disa prona në qytet, prona shumë të ngjyera dhe po qe se përdoret

llogjika që thatë ju pak më parë Anxhela që po e kërkoi ai ne ja japim se është në të drejtën e ligjit kjo shikueshmëri në sensin e dobisë në rast konkret po e cilësoj për vendin që është për përmirësimin që kanë bërë, nuk më krijon ndonjë shqetësim personalisht. Por po që se është kjo analogji dhe pas 3 viteve të na vijë për ato që i kemi trëbetuar si e mirë publike se do gjenerojë ca lekë dhe do vihet një objekt, dhe këto para me sa di unë kur privatizohen nuk është se i marrim ne, i merr Ministria .

Këshilltar E.Petriti: Procedura në formën e agjentit vepron Drejtorja e administrimit të pronësisë publike pranë Ministrisë së Financave.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Jo në kuptimin sa % marrim ne.

Këshilltar E.Petriti: Jo ne marrim komplet.

Ekzekutivi A. Dishnica: Marrim një %.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Për rastin konkret ta hedhim në votim por nuk mund të përdoret ky arsyetim që përdoret pak më parë për të ardhmen.

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 21

Vota KUNDËR 2

Vota ABSTENIM 0

Pika 9 e rendit të ditës

PËR DHËNIEN ME HUAPËRDORJE TË AMBIENTEVE TË KONVIKTIT TË SHKOLLËS MEKANIKE ME VENDNDODHJE NË LAGJEN10, BLV RILINDASIT, NR.45, KORÇË SIPAS PLANIMETRIVE BASHKANGJITUR.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Kush e ka përgatitur materialin? Një shpjegim shkurt të lutem.

Ekzekutivi A. Dishnica: Për dhënien me huapërdorje të konviktit të shkollës profesionale Demir Progni me qëllim për ta përdorur për akomodimin e sportistëve ndërtimin e menciës për sportistët, sallës së konferencave, sallës për zhvillimin e analizave sportive dhe sallën e riaftësisimit . Duke qënë se aktualisht ajo nuk është duke u përdorur nga ana e bashkisë mund ta japim me huapërdorje Klubit të Skenderbeut me afat 9-vjeçar.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Në rast se mund të them ndonjë fjalë më shumë për ta sqaruar, bëhet fjalë për një objekt i cili synon mbështetjen e sportit të futbollit, që është një prej sporteve më të

ndjekura dhe më më impakt në komunitet. Ideja është që një strukturë të cilën nuk e kemi pasur në efikasitet dhe që ka qënë në një rrezik të degradimit ta përdorë për ta kthyer në një njësi të akomodimit të sportistëve të futbollit dhe jo vetëm. Ideja është që t'ju shërbejë jo vetëm futbollistëve të ekipit të parë, por projekti është pak më i gjërë. Ti shërbejë edhe akademisë së futbollit, pra të kemi mundësi të sjellim në Korçë të rinj që merren me futboll në moshë të vogël, ti akomodojmë diku, bëhet fjalë këtu, të ndjekin shkollat në qytetin e Korçës, të behen pjesë e akademisë të Skënderbet dhe ti kemi pastaj këto talente që të furnizojnë të ardhmen, ekipin tonë të futbollit. Dhe përdorimi i tretë do të jetë në rastin e organizimit të boot kampeve, të kampeve verore, ka shumë inisiativa të tilla që kryhen edhe nga ekipe të njohura që vijnë bëjnë boot kampe me qëllim seleksionimin e talentëve, por mund të përdoret dhe për faza stërvitore. Korça ka një klimë perfekte për këtë punë, kemi investuar në zona sportive që është nga më të mirat në Shqipëri dhe duam ta zgjerojmë si projekt dhe është mundësia që ti kryejmë të gjitha këto aktivitete, pra ti shërbejë ekipit të parë, ti shërbejë akademisë, t'ju shërbejë boot kampeve, kampionate të ndryshme që mund të bëhen me ekipe të moshave nga qytete të Shqipërisë por edhe më gjërë. Ka shumë gjëra që ne mund ti bëjmë këtu në rast se i krijojmë kushtet për një akomodim të këtyre sportistëve. Dhe ajo çfarë kam diskutuar me përfaqësues të klubit është që përveç këtyre që unë përmenda janë përfitime edhe të bashksië, të kemi mundësinë që një pjesë të atyre ambienteve të kemi mundësi ti përdorim edhe ne si bashki në rast organizim edhe të eventeve të tjera jo në fushën e futbollit. Për shembull patëm një projekt shumë të mirëinteresat që mbyllëm dje, që ishte ky boot kampi i Korça City Akademi, u përmyll dje. Ishin në total 110 të rinj, nga të cilët vetëm 35 nga qyteti i Korçës, ndërsa pjesa tjetër ishin nga e gjithë Shqipëria. Ata mund ti akomodojmë në të ardhmen pasi projekte të tilla do kemi shumë, në një strukturë që do ta gjejmë gjuhën dhe gadishmërinë nga klubi i futbollit për ta përdorur.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Dakord diskutimi kryesor është ky për mua që mos e zgjatim më shumë. Ky klubi i futbollit si do funksionojë, sepse për mua okay përveç meritës të jashtëzakonshme që ka presidenca para 5-6 viteve që e kemi vlerësuar maksimalisht, e kemi shpallur dhe "Qytetar Nderi" ka një fakt që logon e Skënderbeut me vendimet zyrtare sot është e dënuar publikisht botërisht. Si do jetë marrëdhënia me këtë se unë mendova meqënëse ra nga kategoria dhe meqënëse ne kemi shpenzuar kaq shumë këto 2-3 vitet e fundit duke e mbështetur diçka mbi diçka, shpenzime pafund dhe pa efekt dhe shpresat për tu motivuar do të kalojnë, se këtë interpretimin si është, është 10 vjet pjesëmarrje në kompeticione apo 10 vjet kalendarik. Kjo do jepet, si do përdoret? Se e bëjmë fakt të kryer që do e japim pastaj kemi një rregullore si do përdoret, se shumë mirë që do përdoret dhe për aktivitete, isha unë tek ai aktiviteti i fëmijëve ishte i shkëlqyër dhe entuziazmi i fëmijëve për atë projekt ishte shumë i mirë, por konkretisht unë personalisht e them dhe publikisht nuk kam besim që ky klub me këtë mënyrë si është organizuar deri tani dhe si po funksionon do sjellë një vlerë të shtuar për vitet në vijim. Se është rast unik në botë që dënohet logoja dhe personat që drejtonin këtë logo nuk mbajtën përgjegjësi. Tani ne vazhdojmë investojmë në këtë drejtim, mua personalisht nuk më krijon besim.

Këshilltari E. Tare: Me ato familjet që janë të strehuara tek konvikti cfarë do të ndodhë ?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Jo mos hyr fare në atë drejtim se nuk është se po nxjerrim familjet që janë atje , bëhet fjalë për sipërfaqet që janë të lira dhe nuk përdoren sot. Një pjesë të katit të parë një pjesë që nuk është e zënë. Pra nuk po flasim për sipërfaqe që i përdorin ato familje. Tani se u bënë disa pyetje përse i takon futbollit, të gjithë e dini atë situatën në të cilën jemi dhe nga cila unë shpresoj të dalim sa më shpejt por kjo nuk do të thotë që u ndodhëm në këtë situatë dhe ne duhet të heqim dorë nga mbështetja e sportit të futbollit qoftë të sportit profesionist, pra ekipin e parë, ëoftë të akademisë ekipet e moshave apo qoftë dhe ata që janë jashtë akademisë, ata fëmijët në moshën nën 10 vjet mos gaboj që merren atje po nuk janë pjesë e akademisë. Pra mbështetja jonë për këtë sport duhet të vazhdojë dhe ky projekt thashë e ka vetëm një komponent akomodimin e ekipit të parë që gjithsesi do të duhet ta zgjidhim , por krijon dhe mundësinë që të sjellim fëmijë dhe të ngrejme akademinë, të mgrejme talentet e Korçës dhe të Shqipërisë. Përse i takon rezultatit sportiv është një cikël më komplekse se ju e keni parë që në kategorinë e parë ka rënë dhe Tirana pastaj është ngjitur doli kampion, ka rënë edhe Shkodra dhe u ringjiti. Ambicia ime se nuk mjafton vetëm ambicia ime, është që ekipi i futbollit të Skënderbeut vitin tjetër të rikthehet në kategorinë superiore dhe të qëndrojmë atje. Në momentin e parë kur dënimi ose do jetë shuar ose mund të jetë lehtësuar ne ti rikthehemi rezultateve sportive jo vetëm në nivel të kampionatit kombëtar të futbollit por edhe në nivel European. Kjo është ëndrra ime për Skënderbeun. Nuk kam qënë shumë tifoz i madh i futbollit më përpara, jam bërë këto vitet e fundit edhe për shkak të punës këtu si kryetar bashkie dhe për shkak të rezultateve . E dëshiroj shumë që Skënderbeu të jetë në elitë dhe ekipi i parëtë shërbejë si motiv edhe për fëmijët. Nga ana e menaxhimit të pronës, është një pronë e cila nuk është se ka qënë në përdorim. E kemi parë se si na ka degraduar dhe ata do të marrin përsipër dhe të investojnë në pjesën e ambienteve të brendshme do ti shërbejë ekipit të parë , do ti shërbejë akademisë , do t'ju shërbejë këtyre eventeve verore dhe jo vetëm që mund të organizojmë. Të kesh një strukturë akomoduse që mund ta përodrësh në funksion të këtyre është një gjë shumë e madhe. Mbi këtë dhe mbi të sportive që i kemi mund të ideojmë dhe të projektojmë shumë gjëra interesante dhe plus do jetë parësorja akomodimi i fëmijëve që mund të vijnë për qëllime të tjera jashtë futbollit por e kemi në gadishmëri për ta përdorur edhe për projekte të tjera.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Sa kosto shtesë do kemi për këtë përveç ambientit që japim?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Nuk do kemi kosto shtesë në këtë moment.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Se infrastruktura e bujtjes së qytetit nuk mungon. Për idenë për 10 vjet mbështetje, në 10 vjet që ta mbështesim futbollin në kushtet që nuk kemi pritshmëri thjesht me idenë që do ndodhë pas 10 viteve i bie që ne të harxhojmë afërsisht në vit rreth 450,000,000 mos gaboj për diçka.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Po jo pra tani.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Ja le të na i thotë financa.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Tani më fal , në mos gaboju është 35,000,000 diçka e tillë, të cilat nuk janë pak por nuk janë as 45, për të qënë korrekt me shifrat.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Vjet kemi bërë dhe shtesa në fund të vitit.

Këshilltar E.Petriti: Unë do i drejtoj disa pyetje ekzekutivit: Së pari pse e zgjedhim ne të huapërdorim dhe nuk është zgjedhur një vënd tjetër, së dyti ka ndonjë ide sa do jetë investimi se mos mes këtyre 5 vite na ndodh 450 % investim dhe pastaj , së treti pse u gjend në këtë moment kjo lloj dhënie të themi benefit, në kohën që kryetar thuhet që ai person apo ai grup personash duhet që këtij Këshill dhe qytetit të Korçës i ka një borxh shumë të madhe për të dhënë edhe pse janë në një situatë përsa i përket aspektit ndërkombëtar dhe shpresoj të dalë ajo ëndrra tënde po kam përshtypjen jo konviktin të japim ne po Korçën të japim kam frikë se do lozim me kërcyell vitin që vjen.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Po përgjigjem me rradhë, kemi zgjedhur formën e huapërdorjes se forma tjetër do ishte t'ja jepnim me qira, tani bashkia në përgjithësi si koncept nuk është se shoqëri aksionere që e mat rezultatin bazuar mbi fitimin që gjeneron, sepse ne kemi dhe atë funksionin publik që është shumë i rëndësishëm dhe me përmbushje të një funksioni publik sic është mbështetja e sportit nuk është shumë e rëndësishme që të gjenerojmë të ardhura. E japim me strukturën që e kemi pasur jo funksionale me huapërdorje, vërtet nuk marrim të ardhura por e ruajmë si strukturë, sepse do investohet dhe e përdorim për një qëllim, pra nuk e lemë bosh siç ka kaluar në këto 15 vjet që kam unë në bashki. E dyta jo nuk jemi në kushtet ku mund të ketë kërkesë për tu privatizuar për shkak të plotësimit të kushteve që ka ligji sepse në raste të huapërdorjes nuk aplikohet e drejta e privatizimit, aplikohet në rastet e marrjes me qira jo në huapërdorje, dhe e dyta nuk po flasim për investime të nivelit të 150% të vlerës të objektit. Pra ai klubi i futbollit do të bëjë disa investime për ta përshtatur strukturën me qëllim akomodimin me standartet e tanishme. E treta ishte kjo marrëdhënia bashki dhe president në raport me futbollin. Kjo tani do ishte një temë shumë e gjërë, unë do e ngushtoj pak. Tani e përmbledhur ajo ideja time për këtë bashkëpunim është kjo, ekipi i futbollit të Skënderbeut dhe klubi i futbollit është një klub historik në Shqipëri, më i vjetri pra i vitit 1999 por përtej kësaj ne me sa e njohim futbollin me përjashtim të 1 ose 2 kampionateve në gjithë këtë histori përgjithsisht nuk kemi qënë në elitën e futbollit Shqiptar dhe rezultatet më të mira i kemi patur në presidencën e Agim Zeqos. Tani t'ja japim dhe njëhërë Çezarit atë që i takon Çezarit. Patjetër Agim Zeqoja dhe ata të tjerët që e mbështetën projektin në fillim dhe që patën ato rezultatet e para të daljes së Skënderbeut kampion, por rezultatet në nivel të futbollit europian kanë qënë në Skënderben e

drejtuar nga presidenti aktual. Rezultate që dhe sot e kësaj dite po vërtiten dhe ekipe të tjera. Nuk marr përsipër të jap një konkluzion për atë vendimin e UEF-ës, është shumë e debatueshme , për mua është dënim shumë i rëndë për ato prova që ka disponuar UEFA, por nuk ka rëndësi është dhënë një dënim. Afati i dënimit është 10 vjet kalendarik jo pjesëmarrës, jemi në mes të dënimit. Shpresoj shumë që UEFA siç e rëndoi dorën kur na dënoi tani ta lehtësojë pak. Kurse përsa i takon kësaj pjesës të eficientës, se i kam ndjekur dhe këto diskutimet që okay ky presidenti na bëri këtë na bëri atë , i harrojnë rezultatet pozitive. Pra merremi vetëm me këtë të tanishmen nuk merremi me atë të para pak viteve ku theshin fjalët më të mira, por pavarësisht fjalëve që dëgjoj nuk është se më ka erdhur dikush, ndonjë investitor me ndonjë propozim tjetër, është ndonjë tjetër i interesuar të vijë ta marrë ekipin?

Këshilltar E.Petriti: Duhet të kesh rol aktiv, jo rol pasiv, sepse nëse di historikun e Skënderbeut aktual dhe as Nikos nuk i vajti askush i gjeti një burrë që ishte ministër financash, i gjeti këta Korçarët i bëri bashkë, nesë e di historikun dhe e bëri atë Skënderbe që është, dhe ju në tilla kushte duhet të kërkoni investitorë. Tani jo se ky na ka shpallur ne kampion dhe jep 300,000,000 lekë jep këtë jep atë, sepse e kemi pasur njëherë kampion.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Enver Hoxha na çliroi nga fashizmi e mbajtëm 45 vjet. Tani ç'na gjen e ne ta mbajmë këtë 10 vjet.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Tani është e vërtetë që ne e mbështesim futbollin në vazhdim, i japim atë mbështetje buxhetore që japim, marrim edhe nisma të këtu, në këndvështrimin tim shumë mirë bëjmë që i marrim. Këtij projekti i është bashkëngjitur edhe një investitor privat që është presidenti aktual. Tani nuk po hyjmë shumë në detaje sa jep ai, jep 5, 10, 100, 1,000. A jep 5 lekë ai përtej buxhetit si mendon ti ?

Këshilltar E.Petriti: Është një sistem informativ ose ja u tregon juve ose na i tregoni juve ne, nuk e di. Se çfarë bëhet, këto para ku venë, të tëra duam ti dimë se ç'bëhet se 300,000,000 lekë nuk janë pak në këtë kohë dhe për bashkinë e Korçës.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Jo pak nuk janë, ideja është që të mos e mbështetim sportin e futbollit ? Kush është kërkesa?

Këshilltar E.Petriti: Të kërkojmë llogari.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Atëhere mbështetja buxhetore e bashkisë të Korçës nuk është për zëra të paverifikueshëm, është për dy zëra : trajtim ushqimor që janë sipas ligjit dhe dieta që janë përsëri sipas ligjit. Nuk është se japim ne një mbështetje , japim x lekë dhe prishi ti për çfarë të duash, dhe nga na vajtën. Në drejtim të kontributeve gjëja më e thjeshtë që mund të thuhet është që nuk e dimë sesa mbështet presidenti mund të themi këtu por dimë që mbështet, s'ka rëndësi 5.

Për ato 5 që jep do i themi faleminderit, se nuk është se po na merr. Përveç këtyre që japim ne, dhe ne marrim.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Di t'ju sjell një shembull konkret që e hoqën megjithëse e kishim të federuar, ishte në mjekim i çuan nga ekipi prapë dhe i hoqën nga trajtimet dhe nga pagat që nuk i kanë marrë fare që i gënjejnë do ti marrim do ti marrim.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Unë di të them këtë gjë , që mbështetja e bashkisë për ekipin e parë shkon për trajtimin ushqimor dhe për dietat dhe këto ju kalojnë individualisht sportistëve në llogari.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Po pra nëpërmjet listës që çon klubi. Në lista ata çojnë çfarë kanë qejf , ky është problemi. E kam me emer mbiemër.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Unë nuk e kam këtë rastin konkret.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Bile jam interesuar kam pyetur, nuk ja kanë çuar emrin dhe ky është problemi që nuk ka transparencë. Ne tjetër gjë si institucion, por edhe partneri me atë kontribut që jep se s'japin pak. Sot kemi kontribuar në infrastrukturë dhe vazhdojmë kontribojmë. Kontribojmë me energjinë, jo me pak shpenzime, sot po kontribojmë dhe me ndërtesën.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Shiko të bëj një, se unë jam marrë dhe me futbollin pavarësisht së nuk kam qënë shumë tifoz në atë kohë, që nga viti 2007 që kur kam filluar punë në bashki dhe unë mund të them këtë gjë me përgjegjësi të plotë. Një ekip futbollit nuk mund të jetë i suksesshëm po qe se menaxhohet vetëm nga bashkia . Jo 350,000,000 të vendosë bashkia po sa të duash ti të verë. E kam bindje këtë gjë se mund të vesh lekët por është shumë i rëndësishëm menaxhimi. Kush do merret me lojtarët, kush do ti përzgjedhë kush do shkojë të merret me menaxherët, kush do bëjë kontratat. Mjafton vetëm kjo në këndvështrimin tim, sikur asnjë lekë të mos vinte ky privati, vetëm të bënte menaxhimin e një ekipi futbollit dhe me mua do ishte okay, nuk do i kërkoja gjë tjetër. Tani ky privati që kemi ne, presidenti përveç këtij menaxhimit që është shumë e madhe të na besoni dhe në kontribut dhe në natyrë duke akomoduar lojtarët në resortin e tij, duke i mbajtur me të fjetur me të ngrëna me të pira, faza stërvitore ndeshjet që kanë jashtë Korçës, kontribut në natyrë dhe kontribut financiar për tu plotësuar rrogat atyre lojtarëve që nuk marrin 500,000 lekë sa u japim ne trajtim ushqimor, se i dimë tani sa janë pagat. Pra presidenti krahe atyre që i japim ne ve lekë. Kaq për mua është okay. Tani ajo që na ndodhi, kush e ka fajin, çfarë faj ka presidenti? Kanë ndodhur gjëra të tilla ne ekipe të tjera ne europë, të provuara dhe me faktë dhe ekipet janë dënuar nga 2 vjet dhe këtu deri në 10 vjet , në kuadrin e presupozimeve pra të indicieve jo të provave të vërtetuara. Ky është një diskutim që mund të rrimë dhe një ditë të gjatë dhe të merremi.

Këshilltar E.Petriti: UEFA e kërkoi 2-3 herë marrëveshje dhe marrëveshja që 400 mijë , do të ti sjell me dokumenta, 400 mijë paraprak dhe 3 vjet përjashtim. Jo tha do t'ju thyej hundët juve dhe do të marr 400,000,000 euro.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Mund të ketë pasur bindjen që është pa faj.

Këshilltare I.Nikaj: Meqënëse jemi në këtë çështjen e futbollit dhe unë e mendoj si një histori të shëmtuar që ne nuk duhet të rrijmë kaq gjatë të merremi me këtë, nga ana tjetër mua më kujtohet meqënëse e kam ndjekur përpa krytearit futbollin, Olimpik Marseji ka pasur të tillë histori që u dënua presidenti. Këtu në ne nuk është dënua ndonjë. Më fal unë e quaj përgjegjësi që ne merremi me këtë gjë dhe po tregojmë meritat tona në një histori të turpshme. Kjo histori duhet të marrë fund, sa më shpejt të fshihet aq më mirë është. Pika që kam unë sugjerim është kjo: le të merremi me sporte që i ka traditë Korça dhe që nuk janë objekt skedinash dhe që i mësojnë njerzit për keq, ne kemi plot të tilla, kemi alpinizmin kemi shahun, kemi skitë. Të merremi me disa gjëra dhe t'ju japim disa alternativa fëmijëve dhe të rinjve dhe të rejave këtu, sesa të diskutojmë për Skënderbeun. Nga ky turp nuk çlirohemi ndonjëherë, mbase do ta gjejmë ndonjë lloj qetësimi më vonë por kjo është çështje kohe. Që të rrijmë tani dhe të themi po investojmë se duam të pastrojmë emrin, nuk e pastrojmë dot me këto. Unë mendoj që ne duhet ta harrojmë këtë pjesë dhe të bëjmë sa më pak të tilla shpenzime të cilat nuk na ndihmojnë për ndonjë gjë të madhe. Të merremi me ndonjë sport të cilat do i japin dhe publikut kënaqësi.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Ngrite disa pika shumë të mira profesore, të falenderoj. Nuk është se mbështetja e bashkisë së Korçës ka qënë vetëm për futbollin. Janë shumë të angazhuar të mbështetin të gjitha sportet që ne mund të mbështetim me buxhetin që kemi, duke filluar nga ato sporte që dhe për shkak të traditës dhe për shkak të rezultatit kanë mundësi të tërheqin dhe njerëz. Unë u vonova pak në mbledhjen e këshillit për shkak se isha në takim me grupin me projektin e volejbollit për femra ku pati një rezultat shumë të mirë vitin e kaluar dhe jo vetëm në aspektin sportiv por edhe në tërheqjen e publikut në pallatin e sportit që u rimbush si para viteve 90. Këtë rezultat duam ta mbajmë edhe këtë vit dhe mundësisht ta shtrijmë edhe në sporte të tjera. Unë jam shumë i gatshëm të mbështet të gjitha sportet, se e kam thënë që sa më tepër sporte të mbështetim dhe t'ju krijojmë modele të rinjve dhe të rejave që të shohin raste të suksesshme dhe të ndjekin ata, aq më mirë do jetë për këtë shoqëri dhe për këtë komunitet. Pra jemi duke e bërë këtë gjë. Nga ana tjetër për futbollin nuk thashë që ky investim do pastrojë emrin e futbollit. Thashë që ajo që ka ndodhur ka ndodhur, interesi im dhe përpjekjet e mia do jenë që sa më parë të rikthehmi në elitën e futbollit Shqiptar dhe European. Për pjesën e basteve keq më vjen të të kundërshtoj, nuk është se luajtur, shumë pak mund të kem vënë ndonjë bast, por të garantoj që në kohën që ne jetojmë, jo të gjitha sportet luajnë bast, por luajnë bast edhe qenkat që bëjnë gara. Çfarëdo lloj sporti luan baste. Nuk është teoria më dhemb syri ta kurojmë syrin, se kështu është kjo, na ndodhi ajo që na ndodhi dhe ta lemë mënjane futbollin dhe mos

merremi me futbollin. Është sporti më popullor në kontinentin Europian. Duam s'duam futbolla është që tërheq. Do jemi qytet anti futbollit?

Këshilltare I.Nikaj: Kundra nuk jam unë, kjo është një mashtrim i madh.

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 21

Vota KUNDËR 2

Vota ABSTENIM 0

Pika 10 e rendit të ditës

PËR MIRATIMIN E KONTRIBUTIT TË BASHKISË PËR TVSH, MBIKQYRJEN DHE KOLAUDIMIN PËR OBJEKTIN " PUNIME SHITESË TEK TREGU I GJËSË SË GJALLË " FINANCUAR NGA AZHBR.

Këshilltare E.Mitre :Nuk besoj se komsioni është mbledhur se këto pika janë shitesë

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Mund të them dy fjalë, ju e dini që ne kemi investuar në një projekt të rëndësishëm që është ndërtimi i tregut të gjësë së gjallë që i ka munguar bashkisë të Korcës. Kemi aplikuar dhe kemi siguruar përpara 2 vitesh financimin nga projekti Jaca i qeverisë Italiane dhe është bërë investimi dhe tregu ka filluar nga funksionimi përpara disa javëve, por ka nevojë për plotësim të infrastrukturës më disa investime shitesë. Për këtë kemi aplikuar tek fondet qeverisë në funksion dhe mbështetje të bujqësisë tek AZHBR. Na është miratuar si projekt dhe tani duhet që bashkia të bashkë financojë në pjesën e TVSH-së.

Këshilltare E.Mitre : Ndonjë pyetje nga këshilltarët?

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 22

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 11 e rendit të ditës

PËR MIRATIMIN E RITJES SË PLANIT TË BUXHETIT DHE PËRDORIMIN E GRANDIT PËR OBJEKTIN "PUNIME SHITESË TEK TREGU I GJËSË SË GJALLË" FINANCUAR NGA AZHBR.

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 21

Vota KUNDËR

Vota ABSTENIM 1

Pika 12 e rendit të ditës

INFORMACION MBI ECURINË E REALIZIMIT TË TREGUESVE KRYESORË TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE, PËR PERIUdhËN JANAR-QERSHOR 2022.

Këshilltare E.Mitre : Ekzekutivi e ka fjalën.

Ekzekutivi D.Tabaku: Buxheti i Bashkisë Korçë për vitin 2022 ka një realizim prej 34% dhe krahasuar me planin 6 mujor realizimi është 57%. Nëse e krahasojmë me planin 6 mujor të vitit 2021 ka një rritje prej 1.4%. Përsa i përket realizimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore ajo ka qënë në vlerën 398,000,000 ose realizuar në masën 37% kundrejt planit të të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore ose krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraardhës ka një rritje prej 11.5%. Mund të themi për shpenzimet e personelit të cilat janë realizuar në masën 44% pothuajse në të njëjtin nivel me periudhën e vitit 2021, shpenzimet korrente në masën 34%, shpenzimet për investime në masën 10.3% dhe pagesa për principalin e interesit në masën 36%. Përsa i përket sipas institucioneve mund të themi që bashkia ka bërë një realizim të buxhetit në masën 28%, ndërrmarja e shërbimeve mbështetëse të arsimit dhe çerdhes në masën 44%, ndërrmarja e shërbimeve publike në masën 33%, qendra e artit dhe kulturës në masën 39%, dhe klubi shumësportesh në masën 46%.

Këshilltare E.Mitre: Nuk ka nevojë për miratim sepse është informacion. Për kërkesat dhe ankesat e qytetarëve nuk kemi. Pika të ndryshme.

Këshilltare I.Nikaj: Së pari me ndotjen e mjedisit brenda gati 12 ditësh në pjesën ku jetoj unë janë shkatërruar dhe ato rrugët, trotuaret dhe janë riparuar ashtu në një farë mënyre. Unë mendoj zoti kryetar meqë jeni, përveç lejës që jepni ju duhet të pyesni edhe komunitetin nëse duan ti bëjnë këto gjë. Me një pyetje të thjeshtë venë diku trokasin ke interes, ke shqetësime s'ke, fillojnë dhe shkatërohen hapen rrugët dhe trotuaret dhe ato asnjëherë nuk kthehen në gjëndjen e mëparshme. Unë mund t'ja u tregoj sesi është gjëndja tani nëpër rrugët atje, ku është ndërhyrë, ku janë bërë kanalizime që nuk kthehen asnjëherë në gjëndjen e mëparshme. Është vërtet një situatë e vështirë, së dyti ka një problem që lidhet me mënyrën si funksionojnë institucionet. Ujësjetja në mënyrë të përsëritur aty rreth asaj nuk është në gjëndje të përcaktojë saktë problemin, por ka shkatëruar vazhdimisht njëherë nga ana lindore, perëndimore veriore si ti bjerë, dhe çështja

është që këto dëmtimë që bëhen në struktura të cilat kanë mbi 40 vjet që janë në këmbë nuk i ndihmojnë, përkundrazi i dobësojnë ato. I drejtohem institucioneve të cilat nuk janë në gjëndje të veprojnë. Një proceverbale nuk bën dot policia bashkiake se e pengon drejtori i menaxhimit të territorit apo ujësjellsit. Këto janë dëmtimet të cilat dëmtojnë mjedisin atje por edhe vlerën e pronës që është atje. Pra mënyra se si i riparojnë ata është problematike, lëvizin masat të tëra, atje janë bërë ndryshime në strukturën e katit të parë, në atë vënd ku duan të gërmojnë, të cilën nuk janë konstatuar. Ai kush e ka institucionin të vijë të verifikojë çfarë ka ndodhur në katin e parë në pjesën perëndimore në mënyrë të tillë që të mos kërkojë jashtë atë që është shkatëruar brënda. Ato ndryshime që janë bërë atje kanë qënë pjesë e strukturës mbajtëse të banesës kolektive dhe kjo kërkon një vendimarrje të studiuar, jo vijnë dy puntorë i bien shkallëve i prishin, venë disa çimento të varfër atje dhe ja e mbushëm prapë. Vijnë hapin anët andej këtej, kuptohet nëse rrjedh diku ujë burimi është nga atje brënda nuk është nga jashtë sepse atje janë në përgjithësi struktura që nuk mbajnë ujë sepse janë struktura të hedhura. Të gjithë ata që pretendojnë shumë mund të gjëjnë mënyrën se si është ndërtuar banesa dhe të kuptojnë se çfarë ndodh. Nuk mundet që të vazhdojë kështu tani në mënyrë të përsëritur dëmtohen interesat e njerëzve që jetojnë atje dhe askush nuk merr përgjegjësi. Asnjë proceverbale s'lejohej të bëjë policia bashkiake. Kam thirrur policinë e rendit për të verifikuar e të tjera me rradhë asgjë nuk është bërë, vazhdojmë të kemi të njëjtin problem. Njëherë bie matrapiku, njëherë bien eskavatorët e të tjera me rradhë, absolutisht pa u marrë vesh se si e qysh e tek. Duhet pyetur këta njerëz që janë atje, nuk mund të vazhdohet kështu kjo punë pa asnjë lloj shpjegimi. Vjen një pjestare e stafit teknik të ujësjellsit dhe thotë mos ki merak ti se gjërat janë në rregull. Unë kërkoj përgjigje me shkrim për këtë gjë që nëse në ato struktura bie më shumë se 4 ballë tërmet, ato struktura janë të gatshme për tu shtrirë përtokë.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Tani larg qoftë, unë nuk e di konkretisht ku bëhet fjalë.

Këshilltari I.Nikaj: Në rruga Todi Vogli.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Nuk e di fiks cili pallat është por po e jap shpjegimin dhe pastaj të merremi me pjesën konkrete. Pra për ndërhyrjet ndërtimore që lejojnë në katet e para me kërkesa për ti kthyer nga banim në shërbim.

Këshilltari I.Nikaj: Jo ai është mjedis i përbashkët, ai që është ndërhyrë është pjesë e ndërtimit të strehimit që ka qënë, që është strukturë mbajtëse nuk është pronë për përdorim individual.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Nuk e di konkretisht çfarë është por po them që në miratimet që japim ne si bashki asnjëherë nuk miratojmë ndërhyrje në katet e para që të çenojnë strukturën e pallatit. Nuk miratojmë asnjëherë ndërhyrje të tilla.

Këshilltare I.Nikaj: Nuk pretendova se e keni miratuar ju, kam pretenduar se aty janë bërë ndryshime të tilla që hyjnë në mjediset e përbashkëta kolektive , nuk janë të privatizuara. Tarraca dhe pjesa e bodrumit poshtë nuk janë të privatizuara.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Tani ta them si e mendoj unë.

Këshilltare I.Nikaj: Jo se ju thatë për katet e para, unë nuk po flas për katet e para.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Po mirë atëherë në përgjithësi ne nuk miratojmë asnjë projekt që cënon strukturën e një objekti në bashkëpronësi si parim. Në rastin konkret duhet të bëni një kërkesë tek inspektoriati i ndërtimit të vijë ta shohë në rast se është bërë ndonjë ndërhyrje pa leje. Por ne të japim leje për të ndërhyrë në gjëra strukturore të një objekti në bashkëpronësi, jo nuk e bëjmë. E dyta kuptova që bëhet fjalë për punimet e ujësjellsit, disa ndërhyrje që nuk e kanë gjetur në momentin e parë defektin dhe kanë bërë ndërhyrje tjetër. Tani nuk është se, ndodh domethënë që të mos i bien në kokë difektit që në ndërhyrjen e parë. Pata unë një problem hidraulik në shtëpi dhe e çava në 3 vende derisa e gjeti.

Këshilltare I.Nikaj: E kuptoj, ato foto që kam do ti çoj kryetar që të vlerësosh nëse është dëmi aq sa e keni hapur ju apo është më thellë se kaq.


Kryetari i Bashkisë S.Filo: Përsa i takon ndërhyrjeve për shtrirjen e rrjetit kabllor ne në leje e kemi përcaktuar shumë qartë që situata do të rikthehet në gjëndjen e mëparshme në çdo rast, bile ju kam vënë dhë një kusht që nuk do ecim me idenë që të hapim gjithë qytetin apo shumë lagje dhe pastaj ti mbyllim më vonë, por do ecim me rradhë. Ky është rregulli që ju kam vënë unë, nuk e përjashtoj që mund të ketë devijuar nga ky rregull. E mbajta shënim të interesohem. Përsa i takon punimeve të ujësjellsit, kthimin në gjëndjen e mëparshme përgjithësisht duhet të realizohet nga NSHP-ja e bashkisë , pra kështu e kemi marrëveshjen me ata. Ata kryejnë punimet e tyre dhe paguajnë një tarifë në NSHP për metër katror sipërfaqe që duhet të rehabilitohet dhe rehabilitimin e bëjmë ne. Ka ndodhur i kam konstatuar dhe unë që nuk i përgjigjemi në kohë, për shembull për asfaltimet është e pamundur ti përgjigjesh në kohë se atyre mund ti ndodhë defekti dhe gjatë dimrit apo defekte të vogla dhe nuk është se mund të ndizet linja e asfaltit për të asfaltuar 3 m2, por përgjithësisht janë kujdesur ti zenë në pallaka. Kam parë dhe raste që rehabilitim ka vonuar ka zgjatur në kohë, mund të jetë rasti tuaj i tillë, duhet ta shohim konkretisht.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Eva Naçi



KRYETARI
ERJON NEXHIPI



The stamp is circular and contains the following text: "REPUBLIKA E SHQIPËRISE" at the top, "BASHKIJA E KURVE" at the bottom, and "KRYETARI" in the center. The signature of Erjon Nexhipi is written over the stamp.